



Nga zhvillimi në bujqësi të agroturizmi, plan konkret në 300 ditët e para të mandatit të ri

Faqe 5



Taksa progresive, do të ulet - Premtohet rritja e pagës minimale në 40 mijë lekë në muaj

Faqe 6



Skema Kombëtare, 588 fermerë përfitues për zëvendësimin e plastmasit në serra

Faqe 4



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

E Enjte, 30 Shtator 2021

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 422
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

SFIDAT E ZHVILLIMIT NË SEKTORIN E BLEGTORISË NË SHQIPËRI HUMBJET NË BLEGTORI: KONKURRENCA RAJONALE, BLEGTORËT NË MBIJETESË, PËRPUNUESIT E QUMËSHTIT NË VËSHTIRËSI


Kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Agim Rrapaj, në një intervistë televizive, u ndal në problemet dhe çështjet kryesore që shqetësojnë sektorin e blegtorisë sot në vendin tonë. Rrapaj vuri në dukje edhe faktorët që ndihmojnë në ringritjen e blegtorisë dhe sfidat për arritjen e standardeve të BE-së

RISI ALBANIA

- Mbështetja e projektit RisiAlbania - Osmani: Në Shqipëri është rritur me rreth 500 hektarë sipërfaqja e tokës së certifikuar me certifikatën GlobalGAP, nga rreth 45 hektarë që ishin më parë



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Faqe 2



SHQIPTARËT PËRMBYSIN TRADITËN HISTORIKE
PO I IKIN BLEGTORISË DHE PO ORIENTOHEJN DREJT BUJQËSISË

BILANC TREGTAR



Importet "mposhtin" prodhimin vendas në shumë sektorë

Faqe 7

KËNDI I EKSPERTIT

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË,
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

Investimet në agroturizëm, grante emigrantëve që duan të punojnë në fshat

Transformimi i zonave rurale në peizazhe atraktive, ka nxitur krijimin e agroturizmit si një model i ri i zhvillimit rural në Shqipëri...



Faqe 4

FINANCIM

Programi për bujqësinë, 70 milionë euro për tri shtyllat kryesore



Faqe 4



Faqe 11, 12

Mbështetja e projektit RisiAlbania - Osmani: Në Shqipëri është rritur me rreth 500 hektarë sipërfaqja e tokës së certifikuar me certifikatën GlobalGAP, nga rreth 45 hektarë që ishin më parë

Gramos Osmani, menaxher i Agrobiznesit në projektin RisiAlbania tha se “GlobalGAP, është një certifikatë shumë e rëndësishme sepse i jep vlerë të shtuar produkteve tona dhe është një mundësi që prodhimet made in Albania të aksesojnë tregjet e huaja, ku kërkesa për këtë certifikatë është e madhe. RisiAlbania është një projekt që financohet dhe mbështetet nga qeveria zvicerane, që ka si qëllim nxitjen e punësimit të rinjve në Shqipëri”

implementuar standardin.

Kjo është një certifikatë shumë e rëndësishme sepse i jep vlerë produktit. Është një vlerë e shtuar për produktet tona, është një mundësi që produktet tona të aksesojnë tregje, ku kërkesa për këtë certifikatë është e madhe. Kjo i jep një ndihmë sektorit, sepse falë këtij modeli, shumë eksportues kanë lidhur kontrata bashkëpunimi në Austri e Gjermani

Shumë prej eksportuesve lider, të cilët e filluan këtë iniciativë me mbështetjen tonë, për të prodhuar ato modelet e para, kanë patur vështirësi, sepse u është dashur të bëjnë një sërë investimesh, që nga ato në fermë e deri tek magazina, për të përmbushur të gjitha kriteret e sigurisë ushqimore, të gjurmueshmërisë, pra standardeve që kërkohen nga GlobalGAP. Ky bashkëpunim midis ek-

është një hap shumë i mirë që aktorët në sektor bashkëpunojnë për të çuar më tej këto zhvillime dhe këto standarde.

Po flasim për produktet që kanë të bëjnë me eksport, po për prodhimin vendas a mundën fermerët tanë të kërkojnë certifikim nga GlobalGAP edhe për përdorim të brendshëm?

Kur disa prej eksportuesve filluan të promovonin produk-

huesit furnizon një prej zinxhirëve të ushqimit të shpejtë në Shqipëri, me produkte të certifikuara.

Siç e përmendi zoti Rrapaj, dy rrjete supermarketesh kanë treguar interes dhe kanë shprehur dëshirën për të marrë pjesë në këtë grupin teknik, për të parë mundësinë e një zhvillimi të një standardi LokalGAP apo standardi kombëtar, që mund t'i ofrojë një siguri shtesë kon-

themi rajon, ku po punohet për të qenë treg i përbashkët.

Certifikimi, GlobalGAP apo certifikata të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë ushqimore, me standardet që kërkohen nga tregje të ndryshme na japin atë imazhin, atë pasaportën e parë për të negociuar në marrëdhëniet tregtare dhe patjetër që mbulojnë dhe aspekte shumë të rëndësishme që lidhen me qëndrueshmëri në, pra me atë bujqësinë e qëndrueshme, duke mbrojtur mjedisin, jo vetëm duke prodhuar dhe eksportuar.

Unë do të prek edhe një aspekt tjetër shumë të rëndësishëm. Përveç asaj se çfarë mund të bëjë shteti, aspekt shumë i rëndësishëm është se çfarë mund të bëjë ai eksportuesi, ai tregtari dhe këtu flas si për tregtarët që kanë në fokus eksportet dhe për tregtarët apo rrjetet e supermarketeve që kanë në fokus tregun vendas.

Investimi në burime njerëzore është shumë i rëndësishëm. Të eksportosh në tregje si Gjermania, Austria, Holanda e të tjera, ka nevojë për menaxher eksportesh, ka nevojë për konsulentë shumë të mirë, ka nevojë për një staf shumë të përgatitur për të mbajtur standardet konform atyre kërkesave ndërkombëtare. Kjo të bën më të qëndrueshëm, të bën më të konkurrueshëm në Ballkan e më gjerë. Por gjithashtu duhet të shohim se çfarë kanë bërë gabim vendet e tjera të mëdha siç është Spanja.

Kemi rastin e Almerisë në Spanjë, që është një nga vendet më të mëdha të prodhimit në serra dhe ata sot po t'i pyesësh kanë bërë gabime në të kaluarën. Prandaj ne duhet të fokusohemi shumë, se cila është ajo bujqësia apo zhvillimi i eksporteve i cili është i qëndrueshëm ekonomikisht por edhe duke patur parasysh edhe aspektet e mjedisit.

Dhe aspekt tjetër për tregun vendas do të thosha, duhet më shumë vëmendje nga operatorët, rrjetet e supermarketeve apo tregtarë të mëdhenj, për të pasur një bashkëpunim më të ngushtë me fermerët, për të siguruar konsumatorin vendas, por edhe për të siguruar çmime më të leverdisshme për konsumatorin vendas, për të siguruar vërtet ato varietete, të cilat janë të pëlqyeshme për tregun vendas, jo vetëm varietete që janë të destinuara për eksport.

Kështu që në këtë zhvillim ka rëndësi që secila hallkë të funksionojë në mënyrën e duhur.

Ju falenderoj jo vetëm që ndatë lajmin e mirë, që më në fund ne kemi ferma të cilat janë të certifikuara dhe janë të gatshme për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare, por edhe për faktin që rritet siguria dhe garancia e produkteve tona që është shumë e rëndësishme. Shpresojmë që lajme të tilla të kemi më shpesh.

Intervista e plotë

Zoti Osmani, produktet tona kanë dalë në tregjet ndërkombëtare dhe këtë e kemi fakt. Nuk kanë qenë në sasi të dëshirueshme por gjithmonë kanë dalë edhe duke qenë të certifikuara edhe nga institucione të tjera. Çfarë do të thotë që produktet të jenë të certifikuara nga GlobalGAP dhe çfarë përfitimesh reale sjell në ekonominë e vendit tonë?

RisiAlbania është një projekt që financohet dhe mbështetet nga qeveria zvicerane, që ka si qëllim nxitjen e punësimit të rinjve në Shqipëri. Kjo iniciativë, për të nxitur eksportet shqiptare drejt tregjeve me vlerë të lartë nisi në vitin 2018, me qëllim që eksportet shqiptare të orientohen nga vendet e Ballkanit drejt tregjeve me vlerë të lartë ku normat e fitimit dhe siguria financiare janë më të mëdha. Në këto tregje me vlerë të lartë siç është Gjermania, Austria, Zvicra, Holanda e shumë tregje të mëdha kanë kërkesën e tyre bazë, certifikimin GlobalGAP, i cili është një certifikim që i garanton konsumatorët e tyre për aspektet që kanë të bëjnë me sigurinë ushqimore, gjurmueshmërinë, me aspektet e shëndetit në punë dhe aspektet e mbrojtjes së mjedisit. Në vitin 2018, kur nisi ky bashkëpunim me disa operatorë për të provuar modelin e certifikimit në grup, pra kur një eksportues bashkëpunon me grupin e fermerëve për t'u certifikuar në grup dhe jo thjesht një fermer individual, në Shqipëri sipas GlobalGAP-it kishte rreth 45 hektarë të certifikuar me GlobalGAP, sot që flasim janë rreth 500 hektarë të certifikuar me certifikatën GlobalGAP dhe ky zhvillim shumë i madh ka qenë i mundur falë iniciativës që kanë ndërmarrë eksportuesit për t'u futur në modelin e certifikimit në grup. Pra ata asistojnë fermerët me një sërë shërbimesh, duke filluar nga shërbimet agronomike dhe asistencë për të



“

Aktualisht zhvillimi i GlobalGAP-it dhe i standardeve në Shqipëri, ka shenja shumë pozitive dhe me iniciativë të shumë subjekteve në Shqipëri, u ngrit dhe grupi teknik i punës ku bën pjesë Ministria e Bujqësisë, shoqatat e agrobiznesit, konsulencat shumë të rëndësishme për t'i asistuar eksportuesit dhe ky është një hap shumë i mirë që aktorët në sektor bashkëpunojnë për të çuar më tej këto zhvillime dhe këto standarde.

dhe për më tepër ata kanë lidhur marrëveshje me fermerët, duke i garantuar blerjen e produktit dhe çmimin para sezonit. Kjo do të thotë një situatë drejt bujqësisë me kontratë dhe më shumë stabilitet dhe qëndrueshmëri në fushën e eksporteve.

Ky është një lajm i mirë duke pasur parasysh fatin që produktet tona, nëse arrihet të realizohet në masë shumë më të madhe kontraktimi i fermerëve edhe para se të dalë produkti final në treg. Ky është një lajm shumë i mirë për të gjithë fermerët, por pyetja ime është sa të gatshëm janë fermerët tanë që të marrin ose të realizojnë standardet e GlobalGAP-it e më pas të dalin në treg?

sportuesit dhe fermerit ka qenë i suksesshëm falë investimeve që kanë bërë eksportuesit, duke ngritur ekipin e posaçëm, që bën menaxhimin e cilësisë, pra ndjek të gjitha hallkat e prodhimit, që nga ferma dhe deri te magazina, pra të gjitha hallkat e proceseve për të qenë të suksesshëm dhe për të përmbushur ato kriteret. Por nuk ka qenë e lehtë.

Siç e tha edhe zoti Agim, aktualisht zhvillimi i GlobalGAP-it dhe i standardeve në Shqipëri, ka shenja shumë pozitive dhe me iniciativë të shumë subjekteve në Shqipëri, u ngrit dhe grupi teknik i punës ku bën pjesë Ministria e Bujqësisë, shoqatat e agrobiznesit, konsulencat shumë të rëndësishme për t'i asistuar eksportuesit dhe ky

tet e tyre me GlobalGAP, pati shumë reagime edhe në tregun vendas, pse ne në tregun vendas të mos kemi produkte të certifikuara dhe kjo është shumë e rëndësishme.

Dua të shtoj që edhe këtu ka disa hapa konkrete, ku kemi së fundmi rastin e një prej Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor (SH.B.B.) në zonën e Sarandës, e cila është certifikuar me GlobalGAP në grup së bashku me fermerët që bashkëpunojnë me këtë kooperativë dhe fatmirësisht, kanë lidhur edhe kontrata bashkëpunimi me dy prej rrjeteve të supermarketeve në zonën e jugut.

Gjithashtu një prej eksportuesve që është i certifikuar me GlobalGAP së bashku prod-

sumatorit vendas.

Jemi në fazën kur po diskutohet Open Ballkan, ku po diskutohen marrëveshjet për tregjet e përbashkët dhe shpesh kanë qenë shqetësimet që produktet tona nuk kanë cilësinë dhe nuk mundet dot të konkurrojnë produktet e vendeve të rajonit, kjo për shkak të standardit të cilësisë por edhe për shkak të çmimit e të cilin dalin në treg. Certifikimi i produkteve tona a u jep garanci që të mund të mbijetojnë në tregun e përbashkët ballkanik?

Z. Osmani, çfarë mund t'i jepte tjetër shtysë certifikimit për mbijetesën në rajon, sepse tregjet e largëta janë një ëndërr shumë e madhe, por të

INTERVISTA

SFIDAT E ZHVILLIMIT NË SEKTORIN E BLEGTORISË NË SHQIPËRI

HUMBJET NË BLEGTORI: KONKURRENCA RAJONALE, BLEGTORËT NË MBIJETESË, PËRPUNUESIT E QUMËSHTIT NË VËSHTIRËSI

Kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Agim Rrapaj, në një intervistë televizive, u ndal në problemet dhe çështjet kryesore që shqetësojnë sektorin e blegtorisë sot në vendin tonë. Rrapaj vuri në dukje edhe faktorët që ndihmojnë në ringritjen e blegtorisë dhe sfidat për arritjen e standardeve të BE-së

Sektori i blegtorisë u përkeqësua më tej vitin e kaluar, pasi numri i bagëtive ra si për gjedhin, delet dhe dhitë, të cilat ndikuan edhe në rënien e prodhimit të qumështit. Sipas të dhënave të INSTAT, numri i gjedhëve në vitin 2020 është 362.583 krerë, duke shënuar rënie me 12,76 %, në krahasim me vitin 2019. Përqendrimi më i madh i numrit të krerëve është në qarkun e Fierit me 16,15 % dhe në qarkun e Korçës me 10,87 % ndaj numrit gjithsej të gjedhëve.

Në vitin 2020, numri i të leshtave është 1,55 milionë krerë, duke shënuar rënie me 11,40 %, krahasuar me vitin 2019. Kategoria kryesore e të leshtave përbëhet nga delet e qumështit me rreth 75,39 % ndaj numrit gjithsej të tufës. Përqendrimi më i madh i numrit të të leshtave është në qarkun e Vlorës me 23,92 % dhe në qarkun e Korçës me 15,79 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Numri i të dhirtave në vitin 2020 është 774.332 krerë, duke pësuar rënie vjetore me 10,26 %, në krahasim me vitin 2019. Kategoria kryesore përfaqësohet nga dhitë e qumështit me 79,89 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Agim Rrapaj, në një intervistë televizive, u ndal në problemet dhe çështjet kryesore që shqetësojnë sektorin e blegtorisë sot në vendin tonë. Gjithashtu Rrapaj u ndal në faktorët që ndihmojnë në frenimin e rënies dhe ringritjen e blegtorisë, si dhe sfidat që na presin për arritjen e standardeve të BE-së.

Intervista e plotë

Vitet e fundit kemi një rënie të konsiderueshme të numrit të krerëve të bagëtive e si rrjedhojë edhe e sasisë së mishit dhe bulmetit, zoti Rrapaj pse ndodh kjo?

Ka disa arsye:

Së pari, nuk i kushtuam vëmendjen e duhur blegtorisë dhe prodhimeve blegtorale në atë masë që duhej, në mënyrë që të intensifikonim punën dhe të zhblllokoni si fillim eksportin e qëngjave dhe kecape.

Nëse këto produkte nuk do të mund të eksportohen në periudhën e pikut ishte e sigurt që do të vinim në këtë situatë, përballë një tregu konkurrenues nga vënde në të cilët blegtoriala dhe produktet blegtorale subvencionohen më shumë se sa në Shqipëri. Shtimi importit të produkteve blegtorale përfshir dhe kafshët e gjalla bëri që eksportuesit nga këto vende të zënë një pjesë të mirë të tregut në vendin tonë. Pra nuk

cesi reformimit të përfundonte në kohën e duhur. Një sistem i copëzuar dhe i decentralizuar nuk rezultoi eficient. Gjithashtu një faktor tjetër që ka ndikuar negativisht ka qënë dhe mbetet abandonimi i sektorit të zooteknisë dhe ai i investimeve në transportin e kafshëve dhe tregjeve blegtorale. Shqipëria ka 38 tregje blegtorale dhe shumë pak prej tyre mund të plotësojnë kushtet dhe standartet e një tregu të mirëfilltë

me bujqësinë ishin më eficientë pa u ndryshuar politika fiskale.

Së pesti, Informaliteti i lartë, nënvlerësimi investimeve publike dhe zjarret në kullota, mungesa e sistemit të siguracionit, shpopullimi i zonave rurale, mos planifikimi shpenzimeve të duhura për mirëmbajtjen e sistemit RUDA, janë faktorë të tjerë me rëndësi që kanë ndikuar negativisht në situatën jo të mirë egzistuese të blegtorisë.

dhanë përfaqësuesit e Dhomës së bujqësisë gjatë një vizite në Çeki, i cili është një vend me blegtori të zhvilluar krahasuar me tonin. Negociatat me BE për prodhimet blegtorale dhe veçanërisht për qumështin ishin nga më të vështirat. Përfaqësuesit e BE kërkonin me insistim nga Republika Çeke reduktimin e numrit të krerëve dhe të prodhimit blegtoral, që sjell automatikisht falimentin e mijëra blegtorëve. Qumështi

nivel të lart informaliteti krijohet një situatë akoma më e vështirë për të dhënë kredi nga ana e bankës blegtorëve që e zhvillojnë aktivitetin e tyre në kullotat natyrale. Informaliteti mbetet një plagë e madhe, që nuk po dëmton vetëm këtë sektor, por ka dëmtuar gjithë zinxhirin e Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri.

Kur pritet që t'i japë frytë e saj reforma në veterinarë?

Unë besoj që tashmë ka filluar t'i jape frytet e para. Në sektorin publik janë shtuar rreth 350 veterinarë të rinj dhe priten të punësohen akoma më shumë, është rritur buxheti për pagat, janë krijuar 4 agjensi veterinarie në 4 rajone dhe është unifikuar i gjithë sistemi drejtim të veterinarisë. Reforma në veterinarë është një proces i vështirë, por që duhet realizuar pa asnjë hezitim.

A e shikoni të mirë këtë unifikim?

Kudo në vendet e zhvilluara për veterinarinë funksionon sistemi i centralizuar dhe me drejtim vertikal, ky ka rezultuar dhe është sistemi më i mirë. Shqipëria bëri disa eksperimente më parë, por rezultatet e tyre ishin zhgënjyese që e dëmtuan rëndë blegtorinë.

Censusi a është një pasqyrë më e saktë e situatës aktuale në blegtori?

Censusi është një metodë efikase statistikore, për vlerësimin e situatës në një moment të caktuar dhe jo vetëm në blegtori. MBZHR zhvilloi kohët e fundit një census pjesor vetëm për blegtorinë dhe rezultatet që dolën evidentuan faktin që blegtoriala ka një rënie të ndjeshme të numrit të krerëve krahasuar me shifrat zyrtare të publikuara dhe akoma më shumë krahasuar me potencialet që ka Shqipëria. Por informacionet që KASH ka marr nga shoqatat e blegtorisë tërheqin vëmendjen, që edhe ky census pjesor nuk e ka pasqyruar saktë realitetin për numrin e krerëve.

(Vijon në faqen 6)



Duket si një luftë e organizuar, elementi i parë sidomos, i cili na ka çuar në situatën që ne jemi sot, çfarë mendimi keni?

Me këtë situatë në blegtori dhe jo vetëm, po nuk u muarën masa për frenimin e procesit të rënies do të përballemi shumë shpejt me vështirësi akoma më të mëdha, duke filluar me procesin për hapjen e negociatave me BE, por edhe me procesin e hapjes në tregun rajonal, që po projektohet përmes nismës politike Ballkani Hapur. Subvencioni që japin vendet e huaja për blegtorinë, veçanërisht për qumështin, ka qënë dhe është shumë më i madh krahasuar me vendin tonë. Ne subvencionojmë pjesërisht vetëm për numër krerësh, ndërsa në vendet e tjera bëhet për numër krerësh dhe njësi prodhimi. Ne realisht nuk e kemi vlerësuar këtë konkurrencë që ju thatë dhe konkurrenca e pandershme që ushtrohet nga jashtë mbi blegtorët tanë është shumë e madhe. Më kujtohet këshilla që më

është një produkt i cili kërkon treg nga prodhuesit e vëndeve të BE dhe ato të rajonit të Ballkanit perëndimor. Shqipëria nuk ka importuar qumësht të freskët para tre vitesh, në dy vitet e fundit ne kemi arritur të importojmë më shumë se 20% të prodhimit vendas të qumështit të freskët. Kjo është një goditje që po i bëhet prodhuesit vendas në drejtim të gjetjes së tregut të shitjes me interes për qumështin e freskët.

Ju përmendët subvencionin si element kryesor për ta ndihmuar blegtorinë e vendit tone, po kreditimi a është një element i rëndësishëm që mungon?

Sot bankat dhe institucionet e mikrokreditë e njohin mirë situatën dhe problemet e blegtorisë, prognozen e zhvillimit të këtij sektori, dhe në fushën e blegtorisë nuk është e lehtë që të marrësh një kredi edhe për arsye të mungesës së kolateralit. Duke patur edhe një

muarëm masat e duhura, që të parandalonim konkurrencën e pa ndershme nga vendet e rajonit dhe më gjërë. Të cilat edhe përmes kompanive importuese ushtruan dhe po ushtrajnë presion mbi prodhuesit vendas duke ua ulur pa arsye bindëse çmimet e blerjes prodhimit të tyre. Veprim që i ka detyruar blegtorët vendas që të ulin numrin e krerëve dhe per rrjedhojë edhe sasinë e prodhimit blegtoral. Ulja e çmimeve nuk është diçka e keqe për konsumatorin, por kjo ulje çmimesh nuk po reflektohet edhe tek çmimi blerjes nga konsumatori, por vetëm tek çmimi blerjes nga prodhuesit, duke i detyruar shpesh herë shumë nga prodhuesit vendas që produktet blegtorale ti shesin nën koston e tyre.

Së dyti, Organizimi i sektorit të veterinarisë ishte jo eficient, për shumë vite këtë sektor e kemi patur të çorganizuar, të decentralizuar dhe që nuk ju kushtu rëndësi, që pro-

blegtoral. Transporti i kafshëve brënda vendit me mjete të specializuara nuk egziston fare.

Së treti, Politika fiskale e gabuar dhe e pa studiuar nga qeveria, për pasojat negative që do të sillte, për uljen e rimbursimit të TVSH në 6 % nga 20 % që ishte, për prodhimet e blera nga blegtorët vendas.

Së katërti, Çmimet e ushqimit të blegtorisë u rritën ndjeshëm. Në tregun ndërkombëtar kemi një rritje të çmimit si soja, misri, premixet etj. Ne nuk kemi prodhues të specializuar në vend, që të plotësojnë nevojat për ushqimet e blegtorisë. Shpesh kemi importuar edhe jonxhë për arsye të koston së lart të prodhimit vendas. Pra edhe ky fakt ndikoi negativisht në uljen e numrit të krerëve, por edhe në eficientë të këtij sektori. Ne nuk mund të ankohejmë për eficientë e shpenzimeve dhe investimeve në sektorin e blegtorisë, pasi shpenzimet, të ardhurat dhe investimet në blegtori krahasuar

TEMA TË DITËS

Investimet në agroturizëm, grante emigrantëve që duan të punojnë në fshat

Transformimi i zonave rurale në peizazhe atraktive, ka nxitur krijimin e agroturizmit si një model i ri i zhvillimit rural në Shqipëri.

Programi i qeverisë për bujqësinë 4 vitet e ardhshme, ka në fokus të zhvillojë fshatin dhe turizmin rural nëpërmjet mekanizmave mbështetës, për rritjen e aktiviteteve agroturistike dhe bujtinave, që janë bërë atraksione me interes të veçantë për vizitorët dhe turistët e shumtë, që i frekuentojnë ato në çdo stinë të vitit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, parashikon të ultilizojë programe për mbështetjen me fonde nga buxheti i shtetit dhe donatorët, të menuve autentike që zbulojnë zonën dhe i japin vlerë

qëndrimit të vizitorëve.

Përmes këtij programi, synohet të trashëgohen tek brezat e rinj produktet tipike të zonave gjeografike, përmes krijimit të eksperiencave pozitive që të njihen nga të gjithë.



Për këtë nxitja do të jetë reale përmes politikave mbështetëse me grante dhe subvencione dedikuar emigrantëve, të rinjve dhe grave, që duan të jetojnë e punojnë në fshat.

Programi për bujqësinë, 70 milionë euro për tri shtyllat kryesore

Qeveria rrit mbështetjen financiare në mbështetje të zhvillimit të bujqësisë, blegtorisë dhe zhvillimit rural.

Në programin për bujqësinë në 4 vitet e ardhshme, qeveria adreson 70 milionë euro për

tre shtyllat kryesore të këtij sektori, me rëndësi dhe potencial të madh për ekonominë e vendit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca u shpreh të enjten në Ku-

vend: “Programi i qeverisë rrit mbështetjen në bujqësi, blegtori dhe zhvillim rural, me një total prej 70 milionë euro në financimin e drejtpërdrejtë të masave direkte për prodhim, për fermerët e blegtorët”.

Bujqësia mbetet një nga sektorët kryesorë që ka dhënë kontribut të madh në Produktin e Brendshëm Bruto përgjatë këtij viti dhe që do të vijojnë të jenë motor i zhvillimit ekonomik të vendit.

Qeveria po nxit politikën mbështetëse, për të rritur punësimin në sektorin e bujqësisë dhe po zgjeron zhvillimin edhe në agroturizëm për të kontribuar në përmirësimin e ekonomisë rurale.

Skema Kombëtare, 588 fermerë përfitues për zëvendësimin e plastmasit në serra

Është shtuar edhe me 70 fermerë, numri i aplikantëve përfitues në masën “zëvendësim plastmasi në serra ekzistuese” të Skemës Kombëtare të Mbështetjes në

e vijës së financimit për aplikimet në masën 3 mbështetëse të Skemës Kombëtare.

Sipas njoftimit të AZHBR-së, për masën 3: Zëvendësim plastmasi në serra ekzistuese –

në fond aplikimet deri në numrin rendor 588.

Përmes Skemës Kombëtare të Mbështetjes për Bujqësinë 2021, fermerët përfitojnë subvencionim të TVSH-së për plastmasin që përdorin në serra për prodhim bujqësor.

Sipas AZHBR-së, deri tani pagesat janë dhënë për mbi 90 % të fermerëve përfitues. Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2021, ka adresuar një fond prej 804 milionë lekë, subvencione për fermerët.

Sipas të dhënave zyrtare janë 3000 fermerë të kualifikuar deri tani përfitues, për njërin nga 9 masat që mbështet Skema Kombëtare e këtij viti, ndërsa AZHBR njofton herë pas here për uljen e vijës në listën e përfituesve për secilën masë, që do të thotë rritje e numrit të fermerëve përfitues të këtyre fondeve.



Bujqësisë dhe Blegtori 2021. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen

Vija e financimit ishte në numrin rendor 518 dhe pas uljes së vijës së financimit përfitues

Shqipëria fillon procedurat për njohjen reciproke në Rajonin CEFTA të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar

Bizneset shqiptare, që kanë marrë statusin e operatorit ekonomik të autorizuar, do të mund të përfitojnë së shpejti të njëjtat lehtësi që u ofron ky status edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Serbinë.

Vendet anëtare të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA), në përputhje me objektivat politike të Procesit të Berlinit dhe në përgjigje të nevojës për

istratën Doganore me fokus të veçantë jo vetëm e lehtësimin e Operatorëve Ekonomike të Autorizuar brenda vendit por edhe njohjen reciproke të tyre në Rajon, theksuan Doganat.

Për njohjen reciproke të programeve të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (OEA), palët CEFTA janë angazhuar duke miratuar në vitin 2019 “Vendimit Ministri mbi njohjen reciproke të programeve nacionale të OEA”.



thellimin e mëtejshëm të integritetit tregtar në rajon kanë miratuar Protokollin Shtesë 5, i cili gjatë këtyre viteve ka synuar krijimin e sinergjive midis vendeve të rajonit për lehtësimin e tregtisë, njoftoi Drejtoria e Doganave.

Ky Protokoll, pjesë integrale e Marrëveshjes CEFTA ka pasur në fokus dispozitat të cilat mbështeten në detyrime dhe angazhime të marra në kuadër të Marrëveshjes së Lehtësimit të Tregtisë në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT).

Zbatimi i këtij protokolli ka qenë prioritet për Admin-

Gjatë këtyre viteve në bashkëpunim me Sekretariatit CEFTA dhe GIZ, Administrata Doganore ka mundësuar implementimin e të gjithave procedurave që mundësojnë vënien në zbatim të Statusit OEA.

Me fillim e procedurave për njohje reciproke, synohet që AEO-s nga një palë CEFTA t'i jepen të njëjtat përfitime si AEO-s në vendet përkatëse ku u është dhënë një autorizim në Palën CEFTA në të cilën bëhet zhdoganimi. Këto përfitime do të jenë të njëjta me ato që i jepen AEOS brenda territorit të tyre doganor.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA) është një marrëveshje ndërkombëtare e tregtisë mes shteteve që përgjithësisht ndodhen në Europën Juglindore. Anëtarët aktualë të CEFTA përfshijnë Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Serbinë.

Përfitimet e statusit të OEA-ve

a) Një trajtim më i favorshëm në lidhje me vlerësimin e riskut dhe kontrollin :

- Më pak kontrole fizike dhe të dokumentacionit

- Trajtim prioritar dhe njoftim prioritar në rast seleksionimi për kontroll doganor;

- Hapësira specifike përveç zyrave doganore për kontrollin e doganës.

b) Një akses i thjeshtuar apo ekskluziv për disa thjeshtime doganore :

- Reduktimi i nivelit të garancisë apo përjashtim nga garancia;

- Thjeshtime në transit;

- Thjeshtime në vlerë;

- Autorizim për deklarata të thjeshtuara etj.

c) Marrëveshje për njohje të përbashkët me shtete të tjera.

Një OEA-S përfiton lehtësira në kontrole gjatë hyrje – daljeve të mallrave në territorin shqiptar OEA – të në Bashkimin Europian (BE) DPD ka akorduar deri më tani 4 Certifikata për OEA ndërkohë që janë në proces për miratim edhe 4 aplikime të

(Vijon në faqen 6)

“Sofat”, festivali që gjallëroi jetën rurale të Libohovës

“Sofat” festivali kushtuar pasurisë kulturore të jetës rurale mbledhi vizitorë të shumtë gjatë fundjavës që lamë pas, në fshatin Libohovë të Gjirokastres.

Ky festival i kthyer tashmë në traditë solli përgjatë dy ditëve vlerat e larmishme të zonës së Asim Zenelit, Libohovës e në përgjithësi qarkut të Gjirokastres.

Banorët e zonës, por edhe vizitorë të shumtë patën mundësi të vizitojnë baxho e ferma kuajsh, të gatujnë me njerëzit e zonës dhe mbi të gjitha shijuan tingujt e muzikës moderne dhe popullore.

Po ashtu, ata u angazhuan me aktivitetet e fshatit si mbledhja e frutave, zierja e rakisë dhe verës, etj. Kjo sepse “Sofat” është një festival kushtuar stilit të jetesës, shijeve dhe

identitetit të fshatrave të jugut të Shqipërisë.

Të apasionuarit pas turizmit kulturor zhvilluan ture kulturore në Labovën e Kryqit, Teqenë e Melanit, Kalanë e Libohovës. etj. Ndërsa në oborin e shtëpisë muze u zhvillua një takim në kujtim të Mojkom

Zeqos, shkrimtar, historian, kërkues dhe intelektual me origjinë nga Libohova.

Ky festival u vlerësua edhe nga ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, e cila thekson se Shqipëria është një sënduk me thesare të pazbuluara.



INFORMACIONE

Nga zhvillimi në bujqësi te argroturizmi, plan konkret në 300 ditët e para të mandatit të ri

Kryeministri Edi Rama u shpreh se Shqipëria është një nga eksportuesit me të mëdhenj të perimeve në Ballkanin Perëndimor dhe zë vendin e dytë për eksportimin e frutave.

Gjatë falës së tij në Kuvend, Rama theksoi: “Synojmë t’i çojmë eksportet bujqësore në 1 miliard USD”.

“Kemi një plan konkret, që do fillojë të vihet frontalisht në veprim që në 300 ditët e para të mandatit të ri. Në këtë plan synojmë më shumë garanci cilësie të inputeve bujqësore më shumë infrastrukturë moderne grumbullimi, më shumë incentiva për grupimet bujqësore, më shumë transferime dijesh, trajnime, informacion dhe ndërveprim mes institucioneve dhe sipërmarrjeve në fshat”, tha Rama.

Rama veçoi në këtë plan, transformimin e mëtejshëm të Universitetit Bujqësor të Tiranës në bashkëpunim të ngushtë me një nga ekselencat evropiane në arsimin e lartë për zhvillimin rural, me Universite-

tin “Boku” të Vjenës.

“Synimi ynë është t’i kthejmë shkëlqimin UBT-së, në një qendër të përparuar të di-

të mbështetura në forma të ndryshme nga qeveria, në të gjithë territorin rural të vendit”, u shpreh Rama.



jet kombëtare, në funksion të zhvillimit bujqësor dhe rural”, tha ai, teksa u ndal në kapitullin e agroturizmit si një degë krejtësisht të munguar me dekada.

“E kemi hapur rrugën e agroturizmit gjatë mandatit të dytë dhe në këtë mandat duam ta çojmë më tutje me investime më të konsiderueshme private

“Do të hapin një kapitull të ri në fushën e sigurisë ushqimore. Kemi bërë përparime, duke u nisur nga një prapambetje shumë e thellë, ku tetë vite më parë gjëja e gjallë therej në rrugën ku kalonte makina dhe gjaku përplasej në xhamat e makinave. Synojmë të vijojmë të përparojmë”, theksoi Rama.

Importet e frutave e bananeve nga Ekuadori janë dyfishuar që nga 2015-a, “rikthehet” dhe Kolumbia

Importet e frutave dhe arrave të ngrënshme (ku një pjesë të rëndësishme e zënë bananet) nga vendet e Amerikës Latine kanë shënuar një rritje të ndjeshme gjatë viteve të fundit

Kjo tendencë është përforcuar dhe në 7 muajt e parë të këtij viti. Të dhënat e INSTAT bëjnë të ditur se Ekuadori është bërë për herë të parë partneri kryesor tregtar i Shqipërisë për kapitullin e “frutat dhe arrat e ngrënshme” në 7 muajin e parë të 2021, duke ia kaluar Greqisë, që tradicionalisht ishte shteti nga ku ne importonim më shumë këto produkte.

Në krahasim me vitin 2015, importet e këtij kapitulli nga Ekuadori janë dyfishuar, duke arritur në 1.6 miliardë lekë për janar-korrik 2021, ose 38% të totalit (në 2015-n, kjo peshë ishte 23%). Të dhënat e tjera nga Comtrade, që i referohen vitit 2020 tregojnë se pjesa më e madhe e kapitullit të “Fruta e arra të ngrënshme” përbëhet nga bananet.

Frutat dhe arrat e ngrënshme përbënin 84% të importeve nga Ekuadori. Produkti i dytë janë “Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme”, me 13% të totalit. Kolumbia është një tjetër shtet, nga i cili janë rritur ndjeshëm importet në vitet e fundit, që nga 2016. Në krahasim me vitin 2015, importet në total nga ky shtet i Amer-

ikës Latine janë rritur me 38 herë, duke arritur në 1.7 miliardë lekë për 7 muajin 2021, sipas statistikave të publikuara nga INSTAT.

Ndryshe nga Ekuadori, ku tregtia është përqendruar te bananet e frutat, me Kolumbinë

në Portin e Durrësit), tregtia u zhvendos drejt lëndëve djegëse minerale e vajrave (në Maltë u kapën disa herë paletë ku brenda ishte fshehur drogë me destinacion nga Kolumbia drejt Shqipërisë).

Pas një rënieje të fortë në



produktet kanë ndryshuar më shpesh. Fillimisht ishin bananet që gjetën rrugën drejt tregut vendas, me importet e tyre që u pesëfishuan nga 2015-a në 2017-n. Nga 2018-a, (që përkon me kapjen e ngarkesës më të madhe me drogë deri tani prej 613 kg në shkurt të atij viti

2020-ën, produktet që vijnë nga Kolumbia kanë shënuar një rritje të ndjeshme sërish në 7 muajin e këtij viti, duke u trefishuar në raport me vitin e mëparshëm. Sërish dominojnë lëndët djegëse, ndërsa një element i ri që po importohet këto muaj janë produktet kimike.

Eurostat: Shqipëria shpenzon më shumë për bukë në Europë dhe e ka më të shtrenjtën në raport me të ardhurat

Shqipëria, një nga shtetet më të varfra të Europës, renditet si vendi, ku banorët e saj shpenzojnë më shumë për bukë dhe drithëra në raport me të ardhurat e tyre.

Sipas tabelave të publikuara nga Instituti European i Statistikave (Eurostat), shpenzimet nominale për bukë dhe drithëra, si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB-që mat vlerën e mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara nga ekonomia në

së Bashkimit European (treguesi i nivelit të çmimeve, BE-27=100). Por, e matur sipas metodës së fuqisë blerëse (ku mesatarja e Bashkimit European merret si referencë me 1), shqiptarëve u kushton blerja e bukës 87 herë më shtrenjtë se një europiani. (shiko grafi-



një vit) ishin 4.8%, në vitin 2020, më të lartat në Europë (shiko grafikun: Shpenzimet nominale si përqindje ndaj PBB, bukë dhe drithëra, viti 2020).

Viti pandemik ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve për këtë produkt jetësor, teksa në periudhën 2016-2019, ky tregues ishte ulur në 4.7% të PBB-së. Shteti i dytë pas nesh është Rumania, me 4% të PBB-së, si shpenzime për bukë dhe drithëra, Mali i Zi, me 3.9% të GDP-së, i ndjekur nga Bosnjë-Hercegovina me 3.1% dhe Maqedonia me 3%. Edhe Greqia, ndonëse një vend në Bashkimin European, shpenzon 2.7% të GDP-së për bukë dhe drithëra. Serbia, e ka këtë tregues më të ulët në rajon, me 2.4% (të dhënat për Kosovën mungojnë).

Mesatarja e vendeve kandidate dhe potenciale kandidate (përfshijtur Turqinë dhe Kosovën) është 3% e GDP-së, shumë më e lartë se mesatarja prej 1.3% e 27 vendeve të Bashkimit European. Në vlerë absolute, shpenzimet mesatare për banor për bukë e drithëra janë 220 euro në vit, më të lartat në rajon, së bashku me Malin e Zi (266 euro). Nivelin më të ulët në rajon e ka Maqedonia (157 euro) e më pas Serbia (164 euro). Vendet e zhvilluara shpenzojnë më shumë për frymë për këtë produkt, pasi është më i shtrenjtë, por për shkak të të ardhurave të larta, ai nuk rëndon në xhepat e tyre.

Buka më e shtrenjta në Europë sipas fuqisë blerëse


Eurostat raporton se çmimet e bukës e drithërave në Shqipëri ishin sa 70% e mesatares

e deri të ato që nuk janë të domosdoshme, si psh argëtimi. Të ardhurat mesatare për frymë të shqiptarëve janë sa 31% e mesatares së Bashkimit European, më e ulëta në Europë (pas nesh është Bosnja me 32%)

Sipas tabelave të Eurostat, shpenzimet për ushqime dhe pije alkoolike zënë 38% të totalit për familjet shqiptare, në krahasim me 13% që është mesatarja e 27 vendeve të bashkimit European dhe 30.6% që e ka shteti i dytë në listë pas nesh, Maqedonia e Veriut. (Shiko grafikun: Shpenzimet finale për konsum, ushqime dhe pije jo-alkoolike, 2019)

Së fundmi, disa furra në vend kanë rritur çmimin e bukës me 10 lekë, duke e çuar në 80 lekë, me një shtrenjtim rreth 14%. Anëtarë të Shoqatës të Prodhuesve të Bukës, Patiçerive dhe Brumrave thonë se së shpejti rritja e çmimit të bukës me 10 lekë do të ndodhë në të gjithë tregun. Arsyeya kryesore e rritjes të çmimit të bukës është rritja e çmimit të miellit në tregun vendas me 5 lekë/kg që në fillim të muajit gusht.

[Shpenzimet nominale si përqindje ndaj PBB (PBB=100), bukë dhe drithëra, viti 2020]



POLITIKA FISKALE

Taksa progresive, do të ulet - Premtohet rritja e pagës minimale në 40 mijë lekë në muaj

“Shqipëria 2030” është kjo motoja e mandatit të tretë të qeverisë Rama që vjen me një program të ri ekonomik me ndryshime në taksa e mbështetje për sektorë kyç të ekonomisë

Mesatarisht 4.5% në vit, është ky targeti që synon ekzekutivi për rritjen ekonomike të vendit, teksa zotohet për ulje të borxhit publik në nivelin e 60% në fund të mandatit.

Rritja e pagës minimale deri në 40 mijë lekë nga 30 mijë lekë që është aktualisht është edhe fokusi i ekzekutivit, që synon përmes kësaj mase që 435 mijë të punësuar të mos paguajnë taksë për këtë nivel page.

Rritje pagash në mënyrë të përshkallëzuar parashikohen për kategori të caktuara, ku duke nisur nga korriku i vitit 2022, pagat e mësuesve, mjekëve dhe infermierëve do të rriten me 40% deri në fund të mandatit, ndërsa për punonjësit e administratës publike rritja pritet të jetë në masën 30%.

Në fund të mandatit të tretë, paga mesatare në administratë do të shkojë në 85 mijë lekë në muaj, nga 72 mijë lekë që është aktualisht.

Ndryshime do të bëhen edhe në taksimin progresiv, ku tashmë taksa progresive 23% do të aplikohet vetëm për pagat mbi 200 mijë lekë e lart, nga 150 mijë që është aktualisht. Për pagamarrësit me pagë minimale tatimi do të jetë zero

dhe për ato me pagë deri në 200 mijë taksimi do të jetë 13%.

Lehtësi parashikohen edhe në rimbursimin e TVSH-së për bizneset, që prej 1 janarit të 2023 parashikohet të bëhet tërësisht në mënyrë automatische.

Mbështetje për sipërmarrjen premtan qeveria Rama në mandatin e tretë me zero taksa

me pajisje të prodhuara në vend dhe që nuk ndotin mjedisin parashikohet një masë mbështetëse deri në kuotën 40%.

50 milionë euro është garancia që do të vihet në dispozicion të bizneseve të manufakturës të goditura fort nga kriza për përballimin e kostove të kalimit në ciklin e plotë të prodhimit



a progresive, do të ulet/ Premtohet rritja e pagës minimale në 40 mijë lekë në muaj

për bizneset e vogla dhe nxitje të sipërmarrjeve për të rinjtë, duke alokuar për këto të fundit një fond prej 10 milionë euro për start up-et.

Me 5 mijë euro grant do të mbështetet çdo emigrant që kthehet në Shqipëri dhe hap një biznes në vend, teksa me qëllim nxitjen e investimeve

duke promovuar markën Made in Albania.

Në fokus të qeverisë do të jetë edhe Teknologjia dhe Informacioni, pasi sipërmarrjet e këtij sektori do të paguajnë vetëm 5% tatim fitim, ndërsa parashikohet krijimi i një garancie për kreditim për IT prej 50 milionë eurosh.

Humbjet në blegtori: Konkurrenca rajonale, blegtorët në mbijetesë, përpunuesit e qumështit në vështirësi

(Vijon nga faqja 3)

Shqipëria për fat të keq edhe në censusin e plotë të viti 2011 dështoi. Kjo për shkak të mospërgjegjësisë të mirë të procesit dhe të mos bashkëpunimit me shoqatat e blegtorëve të cilat e njohin më mirë realitetin në terren.

Zoti Rrapaj a do të kishin efekt shoqëritë e bashkëpunimit në sektorin e blegtorisë?

Unë kam evidentuar edhe më parë, se në këtë sektor kemi tre grupime blegtorësh, kemi blegtorë që prodhojnë vetëm për konsum vetjak,

një grupim tjetër që u mbetet një tepicë prodhimi pas konsumit vetjak, si dhe kemi një tjetër grupim blegtorësh të cilët prodhojnë kryesisht për tregun vendas. Të tre këta grupime kanë karakteristika të ndryshme. Grupimi i parë është pothuaj informal dhe reduktohet ndjeshëm për arsye të shpopullimit, pasi nuk ka më fuqi punëtore të cilët mund t'u shërbejnë këtyre kafshëve. Grupi i dytë ka problemet që unë përmenda në fillim dhe këta po vazhdojnë të reduktohen ndjeshëm,

ndërsa grupimi i tretë po përballlet me vështirësi si ato të politikave fiskale jo të drejta, konkurrencën e pandershme nga importi, çmimet e larta të ushqimeve të blegtorisë, informalitetin e madh, problemet që ka patur veterinaria dhe zoteknia, etj. Te gjitha këto probleme që përmenda dhe te tjera nuk mund të zgjidhen me formën egzistuese të kooperimit dhe koordinimit. Shoqëritë e bashkëpunimit dhe klasterat janë zgjidhje efikente të cilat janë provuar për efikasitetin e tyre në vendet me blegtori të zhvilluar.

Shqipëria po përballlet edhe me një fenomen tjetër, ju shkarazi ndoshta e përmendët largimin e të rinjve nga zonat blegtorale. A është ky një vepër që ndikon në këtë sektor?

Po ndikon shumë negativisht, pasi sot është shumë e vështirë që të gjejmë një bari për tufat e mëdha të të imtave, të cilat shtegëtojnë, është shumë e vështirë që të bindim të rinjtë të investojnë në këtë veprimtari, pasi duhet më parë që ti bindim për efikasitetin e investimit të tyre në këtë sektor. Nëse një i ri nuk bindet

për efikasitetin në këtë sektor Ai nuk ka arsye që të pranojë për të punuar e investuar në blegtori.

Sipas të dhënave kemi një rritje të madhe të çmimeve, cilët shihni si faktorë kryesorë?

Faktorët kryesor do të ndaja në dy grupime, në faktor objektiv dhe faktorë subjektiv, të cilët për fat të keq aktualisht janë ndërthurur, po veprojnë paralelisht me njeri tjetrin dhe në të njëjtën kohë. Faktorët objektiv janë tërmeti, pandemia Covid -19, konjuktura e tregjeve ndërkombëtare, kushtet e vështira të motit. Faktorët subjektiv janë ato që u përmendën më sipër, ku do të ritheksoja edhe njëherë: Informalitetin e lartë, politika e gabuar fiskale e rimbursimit të TVSH, mangësitë në procesin e kooperimit dhe koordinimit, kostot e larta të prodhimit, pozitat dominuese në tregun e fruta perimeve në Tiranë etj. Unë nuk përjashtoj edhe abuzimet e disa kompanive importuese, të cilat duke përfituar nga situatat e vështira dhe kriza i rrisin çmimet e shitjes me shumicë pa asnjë argument bindës.

Bujqësia ka më pak punëtorë - Pagat e ulëta dhe emigracioni larguan 29 mijë persona nga bujqësia

Bujqësia po vuan mungesën e fuqisë punëtore. Punonjësit në këtë sektor u kurrën me rreth 29.8 mijë persona në tremujorin e dytë të vitit, duke e çuar numrin e tyre në mbi 416 mijë të punësuar në fund te qershorit

Që prej vitit 2012 kur sektori bujqësor numëronte mbi 520.3 mijë persona të punësuar, numri i tyre sipas të dhënave të Instat është ulur me mbi 104 mijë persona, ndërsa tendenca është gjithnjë e në rënie.



Për Ilir Pilkun, ekspert i politikave bujqësore, emigracioni i lartë dhe pagat e ulëta në bujqësi janë faktorët kryesorë që po çojnë në uljen e krahut të punës.

“Në radhë të parë është mungesa e planeve të mirëfillta për zhvillimin e bujqësisë,

nuk kemi studime të mirëfillta tregu. Ajo që shikohet sot në zonat rurale dhe në zonat e bregdetit ku janë aktivitete si agrumet, vreshtaritë ne kemi një problematikë të jashtëzakonshme në gjetjen e fuqisë

punëtore. Nuk ka incentiva dhe qëndrueshmëri në sektorin bujqësor, kjo është një nga arsyet që individët në zonat rurale ndihen më të sigurt duke shkuar në emigracion qoftë edhe me punësim sezonale. Marzhet e fitimit të bujqësisë në prodhimin

primar nuk janë kaq të larta sa ne të jemi konkurrues në paga në raport me vendet fqinje.”

Teksa parashikon një situatë më të përkeqësuar në vijim në këtë sektor si pasojë e zhvendosjes së të rinjve drejt zonave urbane dhe largimit të një pjese të tyre në emigracion, Pilkun thekson nevojën e masave emergjente për frenimin e këtij fenomeni.

“Duhet një plan më i mirë zhvillimi për bujqësinë, kryesisht një orientim më i mirë i fermerëve që lidhet me produktin, varietetin dhe skedat teknologjike që do rrisnin automatikisht efikasitetin e bujqësisë duke bërë që të sjellë edhe paga më të larta të fuqisë punëtore. Mbështetje financiare dhe incentiva për të rinjtë që të qasen drejt bujqësisë.”

Bujqësia është sektori më i madh i ekonomisë shqiptare, por vitet e fundit pesha e saj ka shfaqur një tendencë rënës duke bërë që kontributi saj në Prodhimin e Përgjithshëm Kombëtar të arrijë në 19.2% në fund të vitit 2020.

Rruga e re u solli shumë turistë - Në Theth sfidë mbetet ta mbajnë hapur gjatë dimrit

Numri i turistëve ka qenë shumë herë më i lartë se sa vitin e kaluar kjo falë edhe rrugës së re që është drejt fundit.

Aktualisht segmenti nga Qafa e Thorës deri në qendër të fshatit është asfaltuar. Në Theth bujtinat këtë shtator janë plot me të huaj.

“Jam nga Austria dhe kam 2 ditë këtu në Theth. Me të vërtetë që e kam shijuar këtë pamje madhështore. Është gjithçka e bukur. Rugëtimi deri këtu ishte shumë i mirë

dhe i sigurtë. Nuk e di se si ka qenë rruga më përpara por tani ishte shumë e këndshme për të udhëtuar me makinë. Jam i lumtur që këtu është punuar”, shprehet një turist.

“Na pëlqen shumë Thethi dhe jemi të surprizuar nga gjithçka. Edhe nga rruga e re. Këtu është një botë tjetër. Ishin prindërit e mi të cilët 3 vite më parë vizituan Thethin dhe na sugjeruan edhe ne që të vijmë. Asokohe për ta ka qenë e pamundur të mbërrisnim në fshat me makina

normale për shkak të rrugës, prandaj ne u surprizuar”, shprehet një tjetër turist.

Cesk Berishta, është një prej operatorëve turistik të Thethit, i cili tregon se rruga e re ka sjellë aq shumë turistë, sa shpesh herë ka qenë e pamundur t'u shërbejnë të gjithëve.

Me ndërtimin e rrugës së re, sfidë mbetet mbajtja hapur edhe gjatë stinës së dimrit por për banorët, është e pamundur për shkak se në Qafën e Thorës Dëborra arrin deri në 5 metër.

Shqipëria fillon procedurat për njohjen reciproke në Rajonin CEFTA të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar

(Vijon nga faja 4)

tjera.

DPD po bashkëpunon me Doganat e Rajonit për njohjen e ndërsjelltë të statusit OEA dhe lehtësimin të tregtisë mes vendeve tona.

Kriteret e OEA -ve

Sipas llojit të autorizimit të kërkuar (thjeshtimet doganore apo të sigurisë dhe mbrojtjes), aplikuesi duhet të përmbushë disa kriteret:

- Të mos ketë kryer shkelje të rënda apo të përsëritura të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore;
- Të ketë një sistem menaxhimi tregtar, dhe nëse është e nevojshme regjistra transporti, të cilat lejojnë kryerjen e kontroleve doganore të përshtatshme;
- Të ketë aftësi të mira paguese;
- Te ketë standarde praktike dhe kompetenca ose kualifikime profesionale (OEA-D)

Për statusin e OEA-s, standarde sigurie dhe mbrojtje të përshtatshme:

- Masat e duhura për sigurinë e zinxhirit tregtar
- Integriteti fizik dhe kontroll të aksesit
- Procese logjistike dhe trajtime për lloje të ndryshme mallrash
- Personel i përgjegjshëm dhe identifikim i partnerëve të biznesit.

OPINION

Importet “mposhtin” prodhimin vendas në shumë sektorë

Pesha e industrisë agroushqimore në prodhimin e brendshëm bruto është më e ulët se në vitin 1996. Taksat, kostot e larta të transportit të lëndëve të para dhe mungesa e subvencioneve nga shteti konsiderohen faktorët kryesorë që disa industri të prodhimit agroindustrial kanë ulur peshën në treg, në raport me importet. Po çfarë zgjidhje rekomandojnë shoqatat e prodhimit dhe të eksportove? Në cilët sektorë po përcaktohen hapat konkretë që do të merren për të ardhmen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural?

pandemisë, është shtrenjtuar. Cilësia e ulët e grurit vendas,

PBB-së, varet nga struktura, që do të thotë se pavarësisht rritjes së prodhimit dhe peshës së sektorit bujqësor, ka një rritje apo ulje në sektorë të tjerë.

“Referuar të dhënave administrative të sektorit të agroindustrial në vite (krahasuar me vitin 2013) lidhur me sasitë e prodhimit vërehet rënie kryesisht në sektorin e: mishit të gjedhit të freskët; prodhimit të sallamit; prodhimit të miellit të grurit; ushqimit për kafshë; prodhimit të karamelave, çokollatave, llokumeve; prodhimit të rakisë.

Ndërkohë që rritje ka pasur në sektorët e: peshkut të tharë, të tymosur dhe të kripur; prodhimit të lëngjeve të frutave; prodhimit të vajit të ullirit; prodhimit të gjizës dhe gjalpët, kosit; prodhimit të brumërave; prodhimit të verës, etj”.

Ulet prodhimi i mishit të gjedhit

Nga viti 2017 në treg nisi rënia e peshës së mishit të gjedhit vendas. Sipas të dhënave zyrtare, në vitin 2013, pesha e mishit vendas të gjedhit ishte 98%. Në 2017-n, mishi i gjedhit zinte 50% të peshës në treg dhe në 2020 arriti 16%. Eksperti i ekonomisë, Ervin Resuli, thotë se kjo ka ardhur nga rënia e krerëve të gjedhit, për shkak të mosmbështetjes së sektorit nga shteti dhe emigracionit.

“Sipas të dhënave të INSTAT, në 2019-n, numri i krerëve të gjedhit u turr 11% krahasuar me 2018, gjë që ndikoi në rënia e mishit të freskët të gjedhit. Edhe për këtë vit do të kemi rënie të mishit vendas, pasi çdo ditë ulet numri i krerëve të gjedhit.

Shumë të rinj janë larguar nga fshati në emigracion ose nuk e shohin si punë me leverdi. Mosha e tretë e ka të pamundur të menaxhojë punët e blegtorisë, pasi ato janë të vështira fizikisht. Skemat kombëtare të subvencioneve nuk e kanë në program mbështetjen e gjedhit për mish e për rrjedhojë, ky sektor nuk është në vëmendjen e Ministrisë së Bujqësisë.

Në anën tjetër, për shkak të pandemisë, u ul konsumi i mishit të gjedhit. Në ngjarje familjare dhe në turizëm, konsumi i mishit të gjedhit konsiderohet si produkt luksi dhe çmimi i tij është i shtrenjtë në treg. Në Tiranë, çmimi i shitjes së mishit të gjedhit varion nga 850 lekë/kg deri në 1,200 lekë/kg për shkak të kostos së lartë të lëndëve të para ushqyese të kafshëve siç janë misri, soja, elbi, vitaminat, jonxha e thatë etj.”.

Shtrenjtimi i grurit të importit ka rritur kostot e fabrikave të blojës

Prodhimi i miellit të grurit në vend, në vitin 2020 pësoi rënie të lehtë krahasuar me 2019. Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, prodhimi i miellit të grurit vitin e kaluar ra 1.6% në raport me 2013. Adi Haxhiymeri, zotëruesi i fabrikës “Bloja”, tha se industrialistët vendas bluajnë vetëm grurë të importuar.

Sipas tij, gruri vendas bluhet vetëm për nevoja konsumi nga fermerët dhe për shkak të mungesës së ekonomisë së shkallës nuk blihet nga industrialistët. Rënia e prodhimit të miellit ka ardhur për shkak të çmimit të lartë të shitjes së grurit në tregjet e huaja.

“Çmimi i grurit të importit është shtrenjtuar në të gjitha vendet e botës. Në muajin tetor, gruri u shit 220 dollarë/ton. Aktualisht, në prag të të korave, çmimi i grurit është 305 dollarë/ton. Nga janari i 2021, çmimi i grurit është rreth 30% më i lartë se vjet, për shkak të kërkesës së lartë në tregun global. Edhe pas heqjes së taksave nga Rusia, çmimi mbeti i pandryshuar.

Nuk kemi ndonjë shpresë se çmimi do të ulet. Kjo ka shtuar kostot e prodhimit të miellit. Nga ana tjetër, në të gjitha fabrikat më të mëdha të blojës në vend, lënda e parë sigurohet nga importi. Prodhimi vendas është me cilësi të dobët, për shkak të mungesës së subvencioneve dhe shitet me çmim më të shtrenjtë se importi. Për grurin vendas mbetet problem edhe parcelizimi i tokave, ku secili fermer prodhon sasi të vogla dhe me standarde të ndryshme cilësie. Sa është prodhimi i grurit të një fshati, aq është sasia e grurit që ne bluajmë në ditë në fabrikë”, pohon z. Haxhiymeri.

Prodhuesit e vajit të lulediellit kërkojnë heqjen e çmimit të referencave

Rafineritë e përpunimit të vajit të lulediellit në vend vazhdojnë të jenë të fikura. Kostot e larta të transportit dhe taksat për vajin grexho (të papërpunuar) mbeten faktorët kryesorë se pse kjo industri vijon të jetë e paralizuar.

Ylli Aliaj, importues i vajit të papërpunuar nga Bullgaria, pohon se vijon ta përpunojë vajin e lulediellit në rafinerinë e Maqedonisë. Në kompaninë “Bomira”, në Urën Vajguore, bëhet vetëm ambalazhimi.

“Situata ka për të vazhduar me vite nëse shteti nuk ndryshon mënyrën e taksimit të vajit të papërpunuar. Për vajin grexho në Shqipëri, duke qenë se nuk jemi vend anëtar i BE-së dhe kundrejt shteteve europiane, siç është Bullgaria ku furnizohemi me lëndën e parë, përdoren çmimet e referencës, të cilat janë në nivele shumë të gabuara.

Çmimet e referencës duhet të hiqen menjëherë, pasi janë abuzive. Në dogana nuk pranohet dokumentacioni i produktit të blerë në fabrikë, por iu referohen çmimit të bursës. Shumë fabrika prodhimi jashtë nuk janë të regjistruara në Bursën e Reuters-it që iu referohen administratave doganore.”

Drejtesi i kompanisë “Bomira” thotë se për të është më e leverdishme që vajin e lulediellit ta përpunojë në Maqedoni, pasi taksimi nuk bazohet mbi çmimet e referencës dhe TVSH-ja e produkteve të shportës është 5%. “Në Shqipëri nuk prodhohet asnjë litër vaj luledielli. Të gjithë prodhuesit e vajit janë kthyer në ambalazhues, pasi nuk të leverdis ta përpunosh vajin në Shqipëri, për shkak të kostove të larta”.

Edhe Bajram Dine, përfaqësuesi i kompanisë “Vajra Bimore”, e cila tregon vaj luledielli me logon “Fiol”, pohoi se arsytet pse rafineria qëndron e mbyllur prej dy vitesh janë kostot shumë të larta të vënies në punë, ndërsa

Përpunuesit e qumështit në vështirësi nga skema e TVSH-së

Importi i qumështit në 2019-n u rrit 23% në raport me një vit më parë. Sipas të dhënave të doganave në 2018-n, kur ishte në fuqi skema e vjetër e TVSH-së, importet ishin 3,763 tonë qumësht dhe në 2019, kur nisi zbatimin, skema importet ishin 4,898 tonë. Në 2020, për shkak të karantinës në shumë vende të Europës, importet shënuan rënie 24% krahasuar me 2019.

Përpunuesit e qumështit ngritën si shqetësim se ndryshimet në skemën e TVSH-së të 2019-s, rritën kostot e prodhimit vendas dhe po favorizojnë shitjen e produkteve të importuara. Me skemën e vjetër, vlera e kompensimit ishte 20%, ndërsa nga 1 janari 2019, është 6%, për rrjedhojë pagesa e TVSH-së nga blerësit është së paku trefish më e lartë (kompensimi është TVSH-ja e zbritshme për grumbulluesin e qumështit dhe deklarohet në periudhën tatimore kur është lëshuar faktura e blerjes së qumështit nga fermeri).

“Skema e TVSH-së po rrit shitjen e produkteve të gatshme të importit. Sot, në treg, qumështi i paketuar nga Maqedonia shitet 85 lekë/kutia, duke llogaritur koston e transportit, taksat doganore, me çmim më të ulët se qumështi vendas, që blihet 65 lekë me TVSH nga fermerët. Me këto kosto të larta dhe çmime shitjeje, nëse realizohet mini-Schengen, për hapjen e tregjeve rajonale, ne konkurohemi direkt nga produktet e Serbisë dhe Maqedonisë”, pohoi më herët z. Sajmir Begaj, i kompanisë “Erzeni”.

Sipas përfaqësuesit të kompanisë “Lufra”, Luis Ndreka, shumë operatorë të vegjël të përpunimit



nga shteti prodhuesit nuk janë lehtësuar nga barra fiskale.

“Më parë jemi furnizuar me vaj grexho nga jashtë, por tani nuk importojmë më, pasi nuk jemi të mbrojtur. Ne kemi investuar miliona euro në fabrikë për rafinimin e vajit ushqimor të lulediellit, por nga shteti nuk ka asnjë lehtësi për prodhuesit. Detyrimet janë të njëjta si për atë që importon vaj të përpunuar edhe atë që sjell vaj grexho nga një vend i Bashkimit Europian”.

Vendet kryesore nga importohet vaj janë: Bullgaria, Hungaria, Serbia dhe Ukraina. Për këtë industri, cikli i mbyllur i prodhimit është i përcaktueshëm për shkak të kostove të larta të transportit të vajit të papërpunuar dhe taksave të larta.

të qumështit nuk arritën të mbijetonin për shkak të ndryshimeve fiskale. “Skema ka rritur koston e fabrikave, madje falimentoi edhe disa prej tyre. Për shkak të skemës në treg janë rritur edhe produktet e importuara të bulmetit. Produktet tona nuk janë konkurruese në rajon për shkak të kostos së lartë. Qumështi nga Serbia vjen me çmim më të ulët sesa shitet nga fermerët”.

Për këtë arsye, industrialistët propozojnë një skemë të ngjashme si vendet e rajonit, që TVSH-ja të faturohet e njëjtë si në blerje, ashtu edhe në shitje, në nivelet 6 ose 9%. Kërkesa pritet të shqyrtohet nga Ministria e Financave, me hartimin e buxhetit të vitit 2022.

(Vijon në numrin pasardhës)



2016-n. Rritja e vazhdueshme e konsumit në vend dekadën e fundit, në shumë raste ka favorizuar importuesit, teksa hapja e tregjeve nuk i ka bërë bizneset shqiptare më konkurruese, përkundrazi i ka lënë ata zbuluar përballë tregjeve të huaja.

Ndonëse prodhimi në shumë sektorë të agroindustrialisë është rritur vitet e fundit, në disa prej tyre dominimi i importeve është zgjeruar. Industria e birrës, verës, përpunimit të qumështit, prodhimi i miellit, përpunimi i vajit etj, kanë parë një rënie të peshës së prodhimit vendas.

Për birrën dhe verën, prodhimi vendas është ndikuar negativisht për shkak të ndryshimeve fiskale, kostove të larta të prodhimit nga shtrenjtimi i çmimit të energjisë dhe ujit, si dhe mungesës së një rregullatori për të kontrolluar shitjen e produkteve të importit. Sipas prodhuesve, kjo i ka lënë terren importeve.

Nga viti 2017, në tregun vendas ka nisur edhe rënia e prodhimit të mishit të freskët të gjedhit. Ekspertët e blegtorisë nënvizojnë se rënia e numrit të gjedhëve ka ardhur nga mungesa e subvencioneve.

Ndryshimet fiskale të skemës së rimbursimit të TVSH-së në 2019 në sektorin e qumështit janë reflektuar në rritjen e importeve. Në 2019, importi i qumështit u rrit 23% në raport me vitin 2018, kur ende ishte në zbatim skema e vjetër e TVSH-së, sipas të dhënave nga doganat. Përpunuesit pohuan se shtrenjtimi i prodhimit vendas për shkak të TVSh-së po favorizon më tepër shitjen e qumështit të ambalazhuar, që vjen nga jashtë me çmim të ulët.

Te disa sektorë të agroindustrialisë, prodhimi vendas ka pësuar rënie të lehtë, siç është rasti i miellit të grurit. Përfaqësuesit e kompanive më të mëdha të blojës nënvizuan se në fabrikat e tyre bluhet vetëm grurë importi, që për shkak të



TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Kondor (ish parku i autobuzave, poshtë "21 Dhjetorit"), Tiranë
Tel: 0035542239968; Fax/Tel: 0035542220027; e-mail: info@tasegroup.al;
Website: www.tasegroup.al; Celular: 0684855580 (Kushineta, Premistopa dhe rripa)
Celular: 0672035581 (Pjesë këmbimi për traktorë)



Ofrojmë:

- PJESE MOTORIKE
- FREKSIONE
- PERMISTOPA
- KUSHINETA
- RRIPIA
- AKSE
- PJESE ELEKTRIKE
- PJESE HIDRAULIKE
- VAJRA DHE FILTRA



KASH

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





Deri në **4 500 000 LEKË**

KREDI PËR SERA PA KOLATERAL



GJITHMONË FINANCË SOCIALE

Rr. Qemal Stafa, Pall. 9 katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i Ri, Tiranë.
+355 4 2251910/1 | info@fedinvest.al | www.fedinvest.al

Ullinjtë jeshilë apo të zinj? Cilët janë të preferuarit tuaj?

Ngjyra e ullinjve shpesh përbën një faktor në përzgjedhjen e këtij fruti të rëndësishëm, si në rastin e njerëzve që janë të ndarë mes çokolatës së zezë apo asaj me qumësht.

Zgjedhja mes dy ullinjve është tërësisht personale, siç është përzgjedhja e muzikës apo parfumit, por me ullinjtë njerëzit gjithnjë anojnë ndaj atij me ngjyrë jeshile.

Ndryshimi mes ullinjve të zinj dhe jeshilë

Fama e ullinjve për vlerat mjekësore dhe ushqyese nuk është zbehur prej shekujsh.

Biznesi i luleshtrydhes është konsideruar vitet e fundit si një ide e shkëlqyeshme për sipërmarrësit që duan të “provojnë” aftësitë në fushën e bujqësisë. Nuk do të keni nevojë për investime të mëdha dhe viti i parë do t’ju lejojë të rimbursoni kostot fillestare. Së pari, nevojitet një kapital, por sipas ekspertëve të fushës, kthimi i investimit është i shpejtë, pasi duhen 6-7 muaj që të merret prodhimi, duke rikuperuar koston fillestare.

Biznesi për kultivimin e luleshtrydheve ka problemet e veta me të cilat mund të përballen çdo sipërmarrës. Statistikat e konsumit të luleshtrydheve në vend tregojnë se kërkesa për luleshtrydhet po rritet çdo vit. Artur Vrushti është një prej sipërmarrësve i cili po shijon frytet e tregtisë së luleshtrydheve prej 4 vitesh. Ai i mbledh luleshtrydhet nga fermerët e zonës dhe i eksporton ato në rajon dhe Europë. Sipas tij, kërkesa për luleshtrydhe, si në tregun brenda dhe jashtë, është rritur me rreth 20% këtë vit.

Luleshtrydhja përmban vlera të mëdha. Rënia e çmimit në fund të muajit maj dhe qershor rrit më tepër shitjet, sipas z. Vrushti. Ai shton se, teknologjitë moderne dhe varietetet e shumimit lejojnë që luleshtrydhja të rritet edhe në serë. “Këto karakteristika të luleshtrydheve na lejojnë ta kthejmë kultivimin e saj në biznes fitimprurës. Përfitueshmëria e produkteve në dimër mund të jetë deri në 300%. Ne eksportojmë për Europën, jo vetëm për tregti në sezonin e vet, por edhe për industri, si dhe për luleshtrydhe të ngrira, që i përdorin biznese si pasticeri.

Një përfitim i tillë, kaq i madh, është i vështirë për t’u arritur kur rritet kultura të tjera” – thotë z. Vrushti për “Monitor”. “Në tre muaj kemi një pikë prodhimi, këtë vit kemi arritur të mbledhim më shumë se vitet e mëparshme, aq sa kemi arritur të eksportojmë 30-40 tonë luleshtrydhe në ditë”, thotë z. Vrushti, entuziast për prodhimin në Kafaraj.

Sa u përket kushteve klimatike, të cilat vite më parë kanë qenë faktor për problematika për këtë kulturë, këtë vit, z. Vrushti pohon se moti ka qenë

Këto fruta rriten me bollëk në Mesdhe dhe në Shqipëri por edhe në Azinë Qendrore dhe Afrikë.

Ndryshimi mes ullinjve të zinj dhe jeshilë është minimal. Në fakt bëhet fjalë thjesht për nivelin e pjekjes. Ullinjtë jeshilë janë të papjekur mirë, ndërsa ato të zinj janë të pjekur tërësisht.

Një tjetër dallim mes të dyve është se ullinjtë e gjelbër duhen futur në ujë me kripë, ndërsa ullinjtë e zinj nuk kanë nevojë për tretësirë kripe.

Ullinjtë jeshilë përmbajnë më shumë vaj se ullinjtë e zinj. Ullinjtë jeshilë janë më të fortë

dhe kanë më shumë lagështirë, ndërsa ullinjtë e zinj janë të thatë, por kanë shije më të butë.

Shefat e kuzhinës kanë preference të ndryshme në përdorimin e ullinjve jeshilë ose të zinj në menutë e tyre. Shumica përdorin ullinjtë jeshilë për t’u dhënë menuve të tyre një shije pak më të hidhur.

Ullinjtë jeshilë nuk gatuhet as nuk pihen, ndërkohë që ullinjtë e zinj përdoren në gatimet me bazë mishi, sallata, pica dhe panine me brumë pice.

Ullinjtë jeshilë kombinohen me turshi, kaperi, sardele, ba-

jame dhe specia për mbushje të ndryshme, ndërkohë që ullinjtë e zinj jo. Në aspektin e vlerave ushqyese, ndryshimi mes ullinjve jeshilë dhe atyre të zinj është gjithashtu minimal.

Përdorimet në kuzhinë

Ullinjtë jeshilë përdoren në pije alkoolike siç është martini, dhe në sallata, sidomos ajo me vezë. Ato mund të hahen veçmas, por nuk gatuhet ose ngrohen kurrë sepse shija e tyre e fortë mbyt aromën e çdo përbërësi tjetër.

Ullinjtë e zinj nga ana tjetër përdoren gjërësisht për sallata,

pica, makarona dhe gatime të tjera mesdhetare.

Ullinjtë e zinj mund të mos jenë origjinal të zinj

Tingëllon çuditshëm, por ashtu është. Shqipëria prodhon kaq shumë ullinj sa një fenomen i tillë falsifikimi ngjyrash nuk ndodh në vendin tonë.

Megjithatë në vende ku ulliri importohet ndodhin gjëra të çuditshme. Shija e ullinjve të zinj është e thellë, por shpesh konsumatorët e huaj kanë hasur ullinj pa shije apo aromë.

Gati të gjithë ullinjtë e zinj të importuar dhe paket-

uar që shiten nëpër markete, janë thjesht ullinj jeshilë të ngjyrosur.

Nëse merrni ullinj të papjekur dhe i zhyshni në luzione me bazë alkaline apo ujë të oksigjenuar, atëherë ato do të nxihen.

Më pas, përdoret një kimikat që rregullon ngjyrën e ullinjve përpara se ato të palëtohen në tretësirë me kripë.

Etiketa e këtyre produkteve, sigurisht që nuk e përfshin këtë informacion, duke qenë se në teori bëhet fjalë për përpunim se sa thjesht një ngjyrosje.

Nëse do të përballeni me zgjedhjen mes një ulliri të rremë të zi dhe atyre të vertetë jeshilë, zgjidhja është e thjeshtë, apo jo?/AgroWeb.org

tregojnë se shifrat që raportohen për konsum familjar janë shpesh sasia që prishet ose mbetet stok dhe nuk tregtohen. Ata shtojnë se, viti më i mirë për tregti dhe eksport, është padyshim 2021 dhe sezoni ende nuk ka mbaruar.

Luleshtrydhet me deformime, bio apo të dëmshme?

Luleshtrydhet me pamje të çuditshme dhe të deformuara, pamja e tyre nuk do të thotë se janë të pangrënshme. Aq e vërtetë është kjo sa mjaft konsumatorë i preferojnë pasi mendojnë se deformimi ka ardhur, pasi tek luleshtrydhet nuk janë hedhur kimikate dhe substanca të dëmshme që i japin bukuri luleshtrydhes në dëm të cilësisë të luleshtrydhes.

Pjalmim i dobët i luleve të luleshtrydheve. Arsyeja e parë është më e mundshme nga të tëra dhe ka të bëjë me mungesën e pjalmimit të plotë të bimës. Kjo mund të dallohet kundrejt llojeve të tjera të deformimit nga frutat që kanë madhësi të ndryshueshme të farës.

Farat e mëdha janë të pjalmuara ndërsa farërat e vogla nuk arrijnë ta kryejnë procesin.

Kjo ndodh më shpesh në pranverë, kur moti i ftohtë dhe mbulesat që aplikohen nga ngricat nuk lejojnë aktivitetin e plotë dhe funksional të bletëve për pjalmimin e luleve. Dëmtimi nga ngricat. Krahaskuesës së pjalmimit ka edhe një arsye tjetër madhore për luleshtrydhet e dëmtuara, që është si pasojë e ngricave të forta, si ato të dimrit që lamë pas.

Nëse luleshtrydhet nuk kanë pasur mbrojtjen e duhur nga ngricat, kjo direkt mund të shkaktojë deformime. Mangësi në vlerat e tokës ushqyese. Ashtu si të gjitha bimët, luleshtrydhet kanë nevojë për ushqyes. Boroni është një nga mineralet ushqyese në tokë, që i duhet patjetër luleshtrydheve për të prodhuar fruta të mira. Mungesa e boronit shkaktohet nga kullimi i tepërt i tokave. Kur minerali i boronit nuk është në sasi të duhura, shenjat më të dukshmet janë frutat e deformuara, gjethet asimetrike dhe rrënjë të dëmtuara.

Revista "Monitor"

Biznesi i ëmbël i luleshtrydheve

Klima e favorshme në Shqipëri ka nxitur rritjen e prodhimit të luleshtrydheve. Vitet e fundit është parë si një investim i zgjuar, edhe me ndikimin e pandemisë. Fermerët ankohen për zhvlerësimin e çmimit dhe skarcitetin e mallit. Ndërsa bizneset e fushës pohojnë se tregjet e huaja kanë kërkesë të lartë për luleshtrydhen shqiptare

i favorshëm dhe kanë pasur shumë prodhim.

Prodhimi

Çdo frutë e luleshtrydhes vilet me dorë. Në zonën e Kafarajt në Fier, janë mbi 100 hektarë të kultivuara me luleshtrydhe në serra tunel. Mbjelljet e hershme të fidanëve fillojnë nga data 20 shtator deri më 15 tetor dhe ato të vona, nga data 25 tetor deri më 5 nëntor. Vjeljet e para në sasi të kufizuara, sipas fermerëve nisin që nga 25 nëntori, por prodhimi maksimal arrihet nga 15 marsi deri më 15 maj. Gjithsesi, vjelja vazhdon deri në fund të qershorit, kur çmimi është më i ulët.

Tregu kryesor është ai lokal, kryesisht Tirana, por luleshtrydhet e kësaj zone eksportohen dhe jashtë vendit më së shumti në rajon, Bullgari. Vitet e fundit ka pasur kërkesa të larta në Rusi, Çeki, Poloni, Itali etj. Luleshtrydhet janë një investim i zgjuar pasi në Shqipëri, sipas fermerëve, kanë 3 muaj të plotë prodhim, ndryshe nga disa vende të tjera ku prodhimi zgjat vetëm 15 ditë. Pozicioni i Shqipërisë me dëtin në perëndim e bën shumë të favorshme klimën për këtë frutë.

Rendimenti mesatar i kësaj kulture është 400 kv/ha dhe për vitin 2021. Sipas fermerëve, prodhimi pritet të arrijë mbi 4000 tonë. Edhe sipërfaqja e mbjellë është në rritje. Sipas vitit të fundit të raportimit nga Ministria të Bujqësisë, 2019, sipërfaqja e mbjellë është rritur me 8%. Ndërsa, prodhimi në 2019 ka pasur rritje me rreth 17%. Fermerët pohojnë se sipërfaqja është shtuar dy vitet e fundit. Astrit Vrushti thotë për “Monitor” se këtë vit, vetëm ai ka 150 hektarë të mbjellë.

Pandemia

Kultivimi i luleshtrydheve është një biznes i mirë për fermerët. Kërkesa për këtë produkt është e lartë dhe klima e ndihmon kultivimin e

luleshtrydhes në vend. Teksa z. Vrushti pohon se gjatë pandemisë, dy muaj e gjysmë u ndalua gjithçka dhe kjo gjë penalizoi tregtinë me jashtë kryesisht, fermerët e vegjël në fshatin Kafaraj thanë për “Monitor” se, janë përballur me vështirësi.

Astrit Lanaj, fermer prej shumë vitesh në atë zonë, i cili punon bashkë me familjen, pohon se pandemia pati ndikim të madh në të mbjellat e tre muajve.

“E para, paqartësia e krijuar në mars të vitit të shkuar ndali gjithçka. Çfarë nisëm të mbledhjes, e dërguam për tregun e brendshëm te pikat e grumbullimit dhe të shpërndarjes. Kur rinisi aktiviteti disa muaj më vonë, sigurisht pati më pak fitim për ne dhe familjen, Situata ishte e ngjashme edhe për fermerët e tjerë të zonës” - thotë Astriti.

Pavarësisht vështirësive të pandemisë dhe dimrit të ftohtë vitin e kaluar, fermerët pohojnë se e kultivuan sërish luleshtrydhen, dhe prodhimi ishte i mbarë. Por nuk thonë të njëjtën gjë për çmimin, që sipas tyre, luleshtrydhja vijon të jetë e nënçmuar.

Fermerët e zonës Kafaraj, të kontaktuar nga revista “Monitor”, thonë se nuk kanë marrë asnjë ndihmë, përkundrazi janë munduar vetë t’i rikuperojnë dëmet nga mungesa e tregtisë dhe skarciteti i mallit të pashitur. Një pjesë e tyre është dërguar për industri, në përgatitjen e reçeleve. Në lidhje me dëmshpërblimet për shkaqe klimatike, fermerët pohojnë se 2015-a ka qenë viti i fundit kur janë dëmshpërblyer. Ndërsa për situatat e këtij viti, nuk kanë pasur mbështetje nga qeveria lokale. Ata rikujtojnë se, luleshtrydhja është lokalizuar vetëm në Fier dhe se vëmendja e autoriteteve lokale duhet të jetë e fokusuar aty. Astriti pohon se, potenciali është i madh, përveç fermerëve shqiptarë, investimet e huaja

vijojnë të jenë të pranishme, sidomos nga italianët. Eksporti shihet me sy më largpamës, duke marrë parasysh se tregje si Rusia kanë kërkesa të larta për luleshtrydhen shqiptare, pasi bëhet fjalë për një kulturë që ata vetë nuk e kultivojnë dot prej klimës.

Tregtarët, të cilët janë edhe ndërlidhja kryesore mes prodhuesit dhe konsumatorit, thonë se në krahasim me vitin e kaluar, kjo periudhë ka pasur më shumë prodhim dhe çmimi është më i ulët. Një tregtar në zonën e Komunës së Parisit në Tiranë thotë për “Monitor” se ai shkon dhe furnizohet vetë në Fier dhe këtë vit, ka konstatuar se çmimi i produktit është më i ulët.

“Marr një arkë rreth 500 lekë, krahasuar me 700 të dy viteve të fundit dhe 1 kg luleshtrydhe këtë vit e kam tregtuar me 80-100 lekë. Kërkesa ka pasur edhe këtë vit, por një pjesë e mirë na prishet dhe detyrohem të ulim çmimin që ta blejnë amvisat për përgatitje reçeli”, – thotë tregtari në zonën e Komunës së Parisit.

Importi nga Greqia vijon të mbetet shkak për dëmtim të fermerëve vendas. Astrit Lanaj i bën thirrje shtetit që të mbështesë dhe të nxisë prodhimin vendas, si dhe të kufizojë importet, sepse fermerët dëmtohen në këtë mënyrë. “Prodhimi grek na dëmtoi, sepse tregtohet me bursën europiane dhe zbalancoi çmime në treg. Në maj, 1 kg luleshtrydhe shkoi 100 lekë nga minimalisht 200 lekë që duhet të ishte që të nxirrnim kostot tona”- shprehet Astriti.

Biznes familjar

Për shumicën e banorëve në zonën e Kafaraj, puna në serën me luleshtrydhe mbetet si mundësia e vetme e punësimit. “Kam 4 vite që punoj. Jam kthyer nga emigracioni në Greqi. Tentova të punoja në tokat e mia, duke mbjellë sera me domate, por prodhimi nuk

eci. Puna në këto sera është mënyra e vetme për të mbijetuar në të tilla kushte ekonomike. Nëse nuk ecën luleshtrydhja në zonë, ne rrezikojmë të mbetemi pa punë”, thotë Luzim Zutaj, pronar i një sere në Kafaraj.

Tregtarët në Tregun Industrial në kryeqytet pohojnë se prodhimi është i bollshëm, mirëpo kërkesat e tregut të brendshëm janë në rënie. “Situata është përkeqësuar. Së pari, prej mitit që qarkullon ende për hormonet, gjë që ndikoi negativisht edhe në punën tonë. Sot, prodhimin, pasi e marr nga fermeri e çoj në treg, me shpresën që ta shes të gjithin, me të cilat më duhet të mbaj familjen. Punoj prej vitesh në këtë zana. Më parë, ky produkt gjente shitje të madhe në fabrikat e përpunimit për prodhim reçeli. Por këtë vit s’kemi pasur kërkesa. Kemi dëgjuar se për industri kërkojnë më shumë jashtë”, thotë Bardhyli, tregtar.

Gjeografia e prodhimit

Për herë të parë në 2018, luleshtrydhja është mbjellë vetëm në Qarkun e Fierit. Tradita vijon të mbetet e njëjtë. Ndryshe nga viti 2017 dhe vitet paraardhës, ku gjeografia e prodhimit përfshinte edhe rrethet si Lushnja, që ishte e dyta pas Fierit me 14% të prodhimit, ose e shprehur në peshë, ky qark prodhoi 391 tonë luleshtrydhe. Të tjera qytete ishin Durrësi (15 tonë), Dibra (5 tonë), Elbasani (3 tonë).

Shifrat e Ministrisë së Bujqësisë tregojnë se në 2019 (viti i fundit i raportimit), në Rrethin e Fierit u mbollën 121 ha me rrënjë luleshtrydhe, nga të cilat rendimenti ka qenë 436 kv/ha.

I gjithë Qarku i Fierit ka prodhuar më shumë se 5 mijë tonë luleshtrydhe në 2019, të cilat kanë shkruar për konsum vendas, eksport dhe përpunim (kryesisht për reçel), sipas fermerëve.

Fermerët e zonës Kafaraj

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

Teknika e silazhimit me enzimë

Për të marrë silazh të cilësisë së lartë, duhet të kryejmë këto procese pune:

- Korja e bimëve të bëhet në fazën optimale kur kanë grumbulluar 25-30 % të lëndës së thatë. Bimët graminore korren në fazën e qumësht dylit.
- Të gjitha bimët grihen në copa me madhësi deri 20 mm.
- Lagështira të korrigojohet deri sa përmbajtja e lëndës së thatë të arrijë 30-40 %. Korrigjimi bëhet me vyshkje ose përzierje me kashtë.
- Silozi të mbushet dhe të mbulohet brenda 48-72 orësh. Çdo ditë në siloz duhet të hidhet një shtresë mase të paktë 50-60 cm trashësi.
- Bimët graminore të silazhohen të përziera me enzimën SILOSOLVE (FC, AS 200, MC dhe OS) ose enzima të tjera që për çdo ton masë silazhi duhet të hidhet 1-2 gram enzimë e përzier me ujë në temperaturën e ambientit.
- Ngjeshja me traktor të bëhet pas çdo shtrese me trashësi 40 cm deri në mbylljen e silozit.
- Silozi mbulohet me plastmas dhe me një shtresë dheu (15-20 cm) të ngjeshur mirë. Mbulesa kontrollohet vazhdimisht dhe riparohet nëse ka nevojë. Pasi mbaron mbulimi hapen vijat kulluese rreth e për qark silozit me 25 cm të thella dhe 1-1.5 metër larg nga silozi.

Silazhi është gati për konsum 21-42 ditë pas mbulimit. Para se të përdoret silazhit i bëhet vlerësimi i analizës organoleptik dhe kimiko-ushqyes në laborator.

Enzimata mund të përmirësojnë fermentimin e silazhit kur substrati (p.sh., sheqernat) është kufizues. Sheqernat e tretshëm kërkohen për të ndihmuar bakteret të prodhojnë acid laktik, i cili kërkohet për të ulur pH-in e silazhit për fermentimin e duhur. Në përgjithësi, shtimi i enzimave në silazh ka një efekt të vogël pozitiv në fermentim.

Fermentimi në siloz mund të jetë një proces shumë i pakontrolluar që çon në ruajtjen më pak se optimale të ushqyesve. Aditivët e silazhit janë përdorur për të përmirësuar procesin e grumbullimit (energji më të mirë dhe rikuperim të lëndës së thatë) me përmirësime të mëvonshme në performancën e kafshëve.

PËRDORIMI I ENZIMAVE NË SILAZHE

Përgatiti Albi Shehu

Për të kuptuar se si aditivët e silazhit mund të ndihmojnë, së pari duhet të kuptoni procesin e grumbullimit. Fermentimi i silazhit mund të ndahet në 4 faza. Faza e parë karakterizohet nga prania e oksigjenit pasi foragjeret copëtohen dhe pakëtohen në siloz. Frymëmarrja e bimëve vazhdon për disa orë (dhe ndoshta ditë nëse silazhi është i mbushur dobët) dhe enzimata e bimëve (p.sh., proteazat) janë aktive derisa të konsumohet oksigjeni. Gjatë kësaj faze, oksigjeni i tepërt mund të çojë në prishje të padëshiruar të proteinave, ngrohje dhe rritje të tepërt të majave dhe mykut që janë të padëshirueshme. Oksigjeni mund të eliminohet me paketim të shpejtë, shpërndarje të barabartë të foragjereve në strukturën e magazinimit, copëtimin në një gjatësi të saktë dhe ngulitjen në lëndë të thata të rekomanduara për strukturat e veçanta të ruajtjes. Oksigjeni duhet të eliminohet para se të bëhet fermentimi optimal.

Nën kushtet anaerobe (mungesa e oksigjenit) faza e dytë e fermentimit të silazhit dominohet nga aktiviteti mikrobik. Fermentimi kontrollohet kryesisht nga: a) lloji i mikroorganizmave që dominojnë fermentimin, b) substrati i disponueshëm (karbohidrate të tretshme në tretësi) për rritjen e mikrobeve, dhe c) përmbajtja e lagështisë së të korrave. Gjatë kësaj faze, bakteret që prodhojnë acid laktik duhet të përdorin karbohidratet e tretshme në ujë për të prodhuar acid laktik; acidi primar përgjegjës për uljen e pH në silazh. Fermentimet e padëshirueshme nga mikroorganizmat si Enterobakteret dhe Clostridia mund të dominojnë nëse pH nuk bie me shpejtësi. Aty ku e lejon moti, fshirja e foragjereve mbi 30-35% lëndës së thatë para zierjes mund të eliminojë klostridia.

Mungesa e oksigjenit parandalon rritjen e majave dhe mykut dhe pH e ulët parandalon rritjen e shumicës së bakteve gjatë fazës së tretë të fermentimit. Silazh mund të mbahet për periudha të zgjatura kohore nëse mbizotërojnë këto kushte. Faza e fundit dhe e katërt e fermentimit të silazhit

është gjatë ushqyerjes dhe ekspozimit ndaj ajrit. Silazhi i mirë do të mbetet i qëndrueshëm dhe nuk do të ndryshojë në përbërje ose nxehtësi gjatë fazës së tretë dhe të katërt të fermentimit. Silot hermetike dhe heqja e silazhit të mjaftueshëm gjatë ushqyerjes mund të parandalojnë prishjen aerobike.

Produktet përfundimtare të fermentimit të silazhit shpesh monitorohen për të vlerësuar cilësinë e silazhit dhe përbërja e "silazhimeve normale". Shumë laboratorë tregtarë tani ofrojnë shërbime analitike për produktet përfundimtare të silazhit. Lexuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se faktorë të shumtë mund të ndikojnë në përbërjen e silazhit.

Aditivët e silazheve

Fermentimi i silazhit është një proces dinamik që ndikohet nga një sërë faktorësh. Hulumtimi mbi aditivët e silazhit dhe silazhit është kryer për shumë vite.

Lexuesit inkurajohen të zgjerojnë njohuritë e tyre mbi aditivët e silazhit duke rishikuar trupin e gjerë të artikujve të revistave mbi këtë temë. Për më tepër, disa rishikime të shkëlqyera të thelluara janë në dispozicion për këtë temë (Bolsen, 1995; Muck and Kung, 1997; Kung dhe Muck, 1997).

Aditivët e silazhit janë klasifikuar në kategori të ndryshme që përgjithësisht përfshijnë:

- stimulues të fermentimit (inokulantë mikrobikë, enzima, substrate të fermentueshme);
- frenues të fermentimit (acide, konservantë të tjerë);
- aditivë ushqyes (amoniak dhe ure).

Në mënyrë që një shtesë e silazhit të jetë e dobishme, ajo duhet të rrisë shërimin e lëndës ushqyese, të përmirësojë performancën e kafshëve (qumështin, fitimin, gjendjen trupore, riprodhimin), ose të zvogëlojë ngrohjen dhe formimin gjatë ruajtjes dhe ushqimit jashtë. Ndryshimet në produktet përfundimtare të fermentimit pa përmirësime të mat-

shme në një ose më shumë nga këto kategori janë të diskutueshme.

Enzimata aditive

Enzimata janë proteina që ndihmojnë në proceset metabolike. Një shumëllojshmëri enzimesh, veçanërisht ato që tretin fibrat bimore dhe niseshtën, kanë përdorur si aditivë silazhi. Deri më sot, ne nuk mund të gjejmë dëshmi që do të promovonin përdorimin e enzimave të proteazës si aditivë silazhi, pasi ato me shumë mundësi do të rrisnin përqendrimin e proteinave të degradueshme të rumenit në silazh (një rezultat i padëshirueshëm). Aditivët e silazhit mund të përmbajnë komplekse të vetme enzimesh, kombinime të komplekseve të enzimave dhe kombinime të enzimës. Enzimata e tretjes së fibrave të bimëve (celulazat dhe hemicelulasat) janë aditivët më të përdorur enzimatikë dhe do të jenë fokusi i pjesës së mbetur të këtij diskutimi.

Ekzistojnë dy arsye kryesore për shtimin e enzimave që tretin fibrat në silazh. Së pari këto enzima mund të tretin pjesërisht muret qelizore të bimës (celulozë dhe hemicelulozë) duke prodhuar sheqerna të tretshëm të cilët mund të fermentohen nga acidi laktik për të ulur pH e silazhit. Kjo do të stimulonte fermentimin e silazhit dhe do të përmirësonte cilësinë e fermentimit duke rritur shkallën dhe shtrirjen e rënies së pH, duke rritur përqendrimin e acidit laktik, duke përmirësuar raportin e acid laktik: acid acetik (i cili është tregues i efikasitetit më të madh të fermentimit) dhe kështu të zvogëlojë humbjet e lëndës së thatë. Një rënie më e shpejtë e pH do të kufizonte gjithashtu degradimin dhe deaminimin e proteinave të foragjereve dhe do të zvogëlonte prodhimin e amoniakut. Së dyti, tretja e pjesshme e murit qelizor të bimës mund të përmirësojë shkallën ose shtrirjen e tretshmërisë. Në mënyrë që ngjarja e parë të ndodhë, shkalla e hidrolizës së celulozës duhet të përkohet me rritjen e hershme të bakteve të acidit laktik. Për të përmirësuar tretshmërinë, duhet të ndodhë një ndryshim në lidhjen e përbërësve të murit qelizor. (Enzimata e amilazës mund të sigurojnë substrate për acidin laktik duke tretur pjesërisht niseshten, por nuk do të degradojnë fibrat.)

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

KËSHILLA PËR FERMERËT KULTIVUES TË MISRIT, PËR MUAJIN SHTATOR 2021

• Përgatitja dhe korja e misrit për të dy format e përdorimit si kokërr ashtu dhe silazh të misrit me kallinj.

• Misri i destinuar për silazhim duhet të korret kur lënda e thatë në masën bimore që do korret ka arritur nivelet 30-35%. Momenti optimal i korrjes mund të përcaktohet edhe nisur nga treguesi: Vija e qumështit. Praktikisht është vija ndarëse në kokërr mes pjesës së fortë e të butë të kokrrës. Kur ajo është në 1/2 deri në 2/3 e gjatësisë së kokrrës duke filluar nga kurora e saj atëherë themi se është arritur afati optimal i korrjes.

• Nëse përmbajtja e lëndës së thatë na orientojnë për momentin e korrjes, janë disa elementë të tjerë që ndikojnë në cilësinë e silazhit të misrit me kallinj, si:

• Cilësia e silazhit të misrit me kallinj lidhet edhe me shpejtësinë e kryerjes së operacioneve, Korrje + Depozitim

+ Ngjeshje, të cilat duhet të kryhen sa më shpejt të jetë e mundur.

• Misri i destinuar për prodhim kokërr duhet të korret kur lagështia në kokërr ka



Drejtoria e Teknologjive Bujqësore, QTTB-Shkodër,
E-mail: qttbshkoder@yahoo.com rexhaarsen@yahoo.com 0684298298

rënë nën nivelin 18%. Në këto kushte minimizohen thyerjet në kokërr nga korja dhe reduktohen shpenzimet për tharje.

• Në vartësi të kushteve misri mund të

Faktori	Zgjidhja	Karakteristikat
Koha e korrjes	Në fazën e duhur (kur lagështia në kokërr është 40%) Korrja para kohe; Korrje e vonuar.	% e kokrrës në silazh është optimale, koeficienti i asimilimit nga gjedhi është maksimal. Me pak kokërr në silazh, me pak energji dhe humbje të vlerave ushqyese. Përmbajtja e ulët lagështie, vështirësi në ngjeshjen e masës.
Lartësia ne korrje	Lartësia optimale Lartësia e madhe; Lartësia e ulët e korrjes.	Është rreth 20- 25 cm mbi tokë. Korrja në lartësinë 40 cm e lart shoqërohet me përmirësim të cilësisë së silazhit 1.5-2 %, por me ulje të rendimentit mbi 5 %. Në korrjen nën 15 cm, rrezikohet ndotja e masës së silazhit nga dheu e së bashku me të dhe mikroflorë kalbëzuese.
Madhësia e copëtimit	Optimale E madhe E vogël (e shkurtër)	Madhësia optimale e copëtimit është 9-12 cm. Nuk lejon ngjeshje normale të masës. Shton konsumin e agregateve të copëtimit dhe nuk rrit cilësinë e silazhit.
Ngjeshja	Është faktori që siguron silazhimin, cilësinë dhe ruajtjen në kohë.	Norma e ngjeshjes: Me një ngjeshje optimale, në 1 m ³ masë silazhi duhet të ketë 200 kg lëndë të thatë.

thahet në tharëse të posaçme ose mund të ruhet si kalli në kotecë të përgatitur paraprakisht.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga gazeta paraardhëse)

TË USHQYERIT E KAFSHËVE TË FERMËS

Tabela 4. Përmbajtje e rekomandimet mbi përmbajtjen në PB dhe PDR në koncentrat sipas foragjereve

Nr.	Foragjere të përzjera	% në PB në koncentratin e përzjerë	Përmbajtja në PDR në koncentratin e përzjerë
	S.Misri 75 dhe 25% Bar leguminoze	18-20	E lartë
	S.Misri 75 dhe 25% Bar leguminoze	20-22	E Lartë
	S.Misri 50 dhe 50 Bar graminore	17 – 20	E lartë
	S.Misri 50 dhe 50 Bar leguminoze	15-17	Mesatare
Bar leguminozesh			
	Gjthe/ prerje hershme	12-14	Bazë
	Prerje e vonë	15-18	Mesatare
Bar grminore			
	Cilësi e mirë prerje hershme	15-17	Mesatare
	Prerje e vonë	17-20	E lartë
	Bar i përzjer(leguminoze + Graminore) Cilësi mesatare.	15-16	Mesaatare
Kullotat			
	Cilësi e shkëlqyer	14-16	Bazë
	Cilësi e mirë e pranueshme	15 -17	Mesatare

PDR = protein e degradueshme në rumen, PB= protenë bruto

Rumeni dhe mikroorganizmat e tij.

Meqenëse përdorimi i foragjereve nga ripërtypësit varet nga tretja mikrobiale fermentuese, parimet e tretjes në rumen rishikohen përpara se të diskutohen nevojat për inovacione bioteknologjike në fushën e të ushqyerit.

Rumeni është përbërësi kryesor i sistemit tretës të bagëtive. Është shtëpia e një popullsie të dendur dhe shumë të larmishme të mikroorganizmave. Këto fermentojnë substancat në foragjere për të prodhuar kryesisht acide organike me zinxhir të shkurtër ose acide yndyrore të paqëndrueshme (VFA), metan dhe dioksid karboni; procesi siguron bartësin (foragjeret) dhe ATP (energjinë) e nevojshme për rritjen e mikroorganizmave.

Asortimenti mikrob në rumen është kompleks dhe varet shumë nga dieta. Agjentët kryesorë që zbërthejnë fibrat, sheqernat, amidonin dhe proteinat në rumen janë të gjithë anaerobe dhe përfshijnë baktere, protozoa dhe kërpudha. Bakteret janë organizmat kryesorë që fillojnë fermentimin e karbohidrateve që përmbahen në membranën e qelizave bimore (Hungate, 1966), por phycomycetes anaerobe ndonjëherë mund të jenë jashtëzakonisht të rëndësishme (shih Bauchop, 1981)

Rekomandime për energji, fibra dhe yndyra në përzierjet e koncentratit

Edhe nëse ajo konsumon 14 deri 16

kg (30 deri 35 lb) koncentrat në ditë, një lopë me prodhim të lartë nuk mund të thithë energji të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e saj në fillimin e laktacionit. Prandaj lopa duhet të tërheqë rezervat e yndyrës në trupin e saj për të plotësuar marrjen e energjisë së saj ushqimore. Yndyrnat rezervë të djegies së trupit mund të japin energjinë e nevojshme, por varësia e energjisë nga rezervat duhet të mbetet e ulët. Mungesa e energjisë ushqimore bën që lopa të bëjë një shpenzim të tepërt të rezervave të trupit të saj. Mobilizimi i shpejtë i lipideve të trupit i shoqëruar nga një konsum i ulët i ushqimit ose energji çon në acetonemi. Lopa humbet peshën dhe ekuilibri i saj energjetik bëhet negativ. Nxehhtësitë e tij janë më pak të dukshme dhe shkalla e konceptimit është më e ulët se ajo e lopëve që përparojnë në gjendjen e trupit dhe dinë një ekuilibër pozitiv të energjisë. Në fillimin e laktacionit, shumica e lopëve me prodhim të lartë janë në gjendje të ulët (kronike) të acetonemisë, e cila paraqet pak probleme përveç humbjes graduale të peshës. Misri është kokrra më e lirë, por është kokrra më energjike, e ndjekur nga elbi dhe më pas tërshëra. Kokrrat janë shumë të pasura me amidon. E tretur nga mikroorganizmat, niseshteja shndërrohet në produkte acidike. Aciditeti i rritur i rumenit ndikon në tretjen e fibrave. Kjo mund të rezultojë në një refuzim të ushqimit, si dhe në një zvogëlim të prodhimit të qumështit dhe përm-

bajtjes së yndyrës së qumështit. Prandaj është e nevojshme të rritet densiteti i energjisë së racionit duke shërbyer më shumë 2.5 kg sojë e pjekur dhe farat e pambukut të pjekur, furnizojnë afërsisht 0.5 kg koncentrat me energji të lartë. Ju gjithashtu duhet të ruani një nivel të mjaftueshëm të fibrave për shëndetin e mirë lopës.

TË USHQYERIT E GJEDHIT TË QUMËSHTIT

Programi i të ushqyerit ndikon me shume së çdo faktor tjetër në produktivitetin dhe leverdishmerine e një ferme qumështi. Efektet e programeve të mira racore dhe të mbarështimit nuk mund të realizohen plotesisht pa një program të mirë të ushqyerin . Gjithashtu mbarështimi i mirë i lopeve me potencial gjenetik të lartë do të rezultojë në një reagim me eficient ndaj një të ushqyeri të mirë.

• Të ushqyerit e lopëve me prodhimtari të lartë është efektiv sepse nevojat në lëndë ushqyese për mirembajtje përben pjesen më te vogel të nevojave totale të lopeve me prodhimtari të larte. Kjo pasqyrohet nëpërmjet raportit me të lartë qumësht:ushqim dhe per pasojë kosto më të ulët për njësi prodhimi tek lopët me prodhimtari më të lartë.

• Prodhimi i lartë i qumeshtit është i mundshëm vetem kur kombinohet një gjenetike e mire me një mbarështim të mirë.

• Hartimi i një racioni ushqimor për të plotësuar nevojat e lopëve në tufë varet nga njohja e shumë faktorëve të tille si madhësia trupore, stadi i laktacionit, niveli i prodhimit dhe stadi i mbarsmërise. Ky proces bëhet më i komplikuar kur aftësia ngrënëse ose sasia e ushqimit të marre është nën nivelin që ka nevojë lopa.

• Sfidat me të cilin ballafaqohen fermerët është plotësimi i nevojave ushqimore të lopëve ndërsa duke minimizuar humbjet në peshë të gjallë, parandalimin e problemeve të tretjes, ruajtjen e një shendeti të mirë dhe që të mbështesë një prodhimtari të lartë të qumështit.

• Prodhimi i qumështit rritet me shpejtësi pas pjelljes dhe arrin pikun ne javën e 4-rt deri 8-te pas pjelljes.

• Sasia e ushqimit e konsumuar gjatë kesaj periudhë nuk i përgjigjet kësaj rritje të prodhimit të qumeshtit për shkak të aftësise ngrënëse të

kufizuar, kështu që sasia e energjisë të siguruar nga dieta është me e vogel së nevojat në energji. Në këtë stad, lopa ndodhet në një balancë negative në energji, duke kuptuar që ajo duhet të përdore rezervat trupore për të plotësuar nevojat e prodhimit. Lopët në këtë stad laktacioni humbasin peshë. Ne qoftëse një lopë pjellë pa pasur rezerva të mjaftueshme për të përballuar këtë balance negative në energji atëhere prodhimi i qumështit do të jetë i ulët.

• Kujdes duhet të tregohet që lopa të mos kalojë në mbi peshë (tej majmëri -kondicion majmërie) përpara se ajo të pjelle.

• Lopët që janë shumë të majme në momentin e pjelljes janë shumë më të ndjeshme ndaj çrregullimeve të ndryshme metabolike. Ndërsa laktacioni avancoon, sasia e ushqimit te konsumuar nga lopa rritet duke arritur pikun rreth 10-14 jave pas pjelljes. Kur sasia e energjise së marrë me ushqimin është më e madhe se sasia e energjisë së nevojitur për prodhim qumeshti, lopa do të fillojë të shtojë në peshë dhe të zëvendësojë rezervat trupore të harxhuara në fillim të laktacionit.

• Gjatë fazës së fundit të laktacionit dhe në periudhën e tharjes, shtesa në peshë të gjallë e lopës se pari duhet të shkaktohet me tepër nga rritja e fetusit se sa nga depozitimi i indit dhjamor.

• Ne qoftëse një lopë është shumë e dobët kur ajo është në periudhën e tharjes, ajo duhet të ushqehet në mënyrë të tillë që të rivendosë rezervat trupore si dhe të mbështesë rritjen e fetusit.

